

HARLAN COBEN
MALL PËR TY
ROMAN

BOTIMET TOENA

HARLAN COBEN

MALL PËR TY

roman

Përktheu nga origjinali anglisht

Maniela Sota

BOTIMET TOENA

Tiranë, 2018

Autori: Harlan Coben (Harlan Koben)

Titulli në original: Missing You

Botoi në anglisht: Penguin Group

Ky libër botohet me mbështetjen
e Ministrisë së Kulturës.



Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo

Redaktore: Besa Vila

Korrektore letrare: Petrina Ago

Përkujdesja grafike: Elida Stafa

Kopertina: Elsa Hajderaj

ISBN 978-9928-235-86-2

© Harlan Coben, 2014

© *në shqip* Botimet Toena, 2018

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollësja", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

E-mail: redaksia@toena.com.al

botimet.toena@gmail.com

www.toena.com.al

1

KEJT Donovan i rrotulloi stolin e vjetër, ku dikur ulej zakonisht babai i saj, dhe u bë gati të dilte nga *O'Malley's Pub*, kur Stejsi i tha:

- Kam bërë diçka që nuk do të të pëlqejë.

Toni i saj e bëri Kejtin të ndalonte në mes të hapit.

- Çfarë?

O'Malley's ishte një bar që frekuentohej nga policë të kohës së vjetër. Gjyshi i Kejtit rrinte atje. Ashtu kishte bërë i ati dhe shokët e tij, kolegë të NYPD-së (Departamenti i Policisë së Qytetit të Nju-Jorkut), ndërsa tani ai ishte kthyer në një bar që frekuentohej nga të rinjtë e pasur, zotër të universit, një bar me budallenj pozantë, i mbushur me djem që vishnin bluza sportive të freskëta, të bardha nën kostumet e zeza, me qimet e mjekrës të parruar prej dy ditësh, të depiluar deri në maksimum dhe që ngjanin të padepiluar. Ata

vazhdimisht buzëqeshnin të vetëkënaqur. Buzëqeshnin të vetëkënaqur, këta njerëz me fytyra të pudrosura, me flokët e llangosur me shkumë, dhe që porosisnin vodka *Ketel One* në vend të vodkës *Grey Goose*, sepse kishin parë disa reklama televizive ku iu tregonin se çfarë pinë burrat e vërtetë.

Sytë e Stejsit filluan të lëviznin me shpejtësi nëpër bar. Ajo po i shmangej. Kejti nuk i pëlqeu kjo gjë.

- Çfarë ke bërë? - pyeti Kejti.

- Hëm, - tha Stejsi.

- Çfarë?

- Një kaqol, ora pesë.

Kejti u kthye djathtas që të shikonte vjedhurazi.

- E pe atë? - pyeti Stejsi.

- Oh, po!

Me një dekor të përshtatshëm, *O'Malley's* në të vërtetë nuk kishte ndryshuar shumë gjatë viteve. Sigurisht, televizorët e vjetër me mbështetëse ishin zëvendësuar nga një mori me ekrane të sheshta, që transmetonin të gjitha garat sportive të mundshme dhe të imagjinueshme - e kush pyet për performancën e Edmonton Oilersit? - por, pa e marrë këtë parasysh, *O'Malley's* e kishte ruajtur atmosferën e dikurshme dhe ishte pikërisht kjo që i ndillte këta pozantë, autenticiteti i imituar, ecejaket e përhershme, gumëzhima, duke e kthyer atë që kishte qenë njëherë e një kohë në një version të *Disney Epcot*-it.

Kejti ishte policja e vetme që kishte mbetur. Të tjerët tani shkonin në shtëpi pas turneve të tyre ose në takime AA, të Alkolizuarit Anonimë. Kejti vinte

ende këtu dhe përpiquej të ulej qetësisht në stolin e vjetër të babait të saj, në shoqërinë e fantazmave të tij. Veçanërisht sonte, ku kujtonte vrasjen e babait të saj, që kishte filluar ta përndiqte përsëri. Donte vetëm që të ishte këtu, të ndiente praninë e babait të saj, si mund të duket e rëndomtë, të merrte forcë prej tij.

Por idiotët nuk do ta linin rehat, apo jo?

Kaqoli kishte bërë një gabim tipik të sojit të tij. Ai mbante syze dielli. Në orën njëmbëdhjetë të natës. Në një bar me ndriçim të dobët. Ndër atributet e tjera të një kaqoli të vërtetë gjeje zinxhirin që i varej te portofoli, shaminë e kokës, këmishën prej mëndafshi të zbërthyer, tatuazhet e shumta (kategori e veçantë për ata që praktikonin simbole tribush), medaljone qensh, pllakëzën e identifikimit, ndërkohë që s'kishte asnjë lidhje me ushtrinë dhe një orë dore të madhe, me zinxhir të bardhë.

Syzja e diellit buzëqeshi i vetëkënaqur dhe ngriti gotën në drejtim të Kejtit dhe Stejsit.

- Po i pëlqyekemi, - tha Stejsi.

- Mjaft erdhe rrotull. Çfarë ishte ajo që nuk do ta pëlqejja unë?

Kur Stejsi u kthye mbrapsht, drejt saj, Kejti mundi të shihte mbi shpatulla zhgënjimin e fytyrës së ndritshme të lyer me locion shumë të shtrenjtë të kaqolit. Kejti e kishte parë atë pamje një milion herë të tjera. Meshkujt e pëlqenin Stejsin. Kjo ndoshta ishte diçka e thënë me rezerva. Stejsi të linte pa frymë, të bënte të të këputeshin gjunjët. Kontakti me të mund të shkrinte

metalin, dhëmbët e kockat. Meshkujt bëheshin si të mpirë dhe në të njëjtë kohë si budallenj pas Stejsit. Shumë budallenj. Me të vërtetë, shumë budallenj.

Ishte pa dyshim e gabuar të dilje me dikë si Stejsi - djemtë shpesh arrinin në përfundimin se nuk kishin më fjalë kur shikonin një femër të tillë. Ajo dukej e paarritshme.

Kejti nuk ishte ashtu.

Syzja e diellit u vardis pas Kejtit dhe filloi të bëjë lëvizjen e tij të parë. Eci paksa drejt saj, sikur po rrëshqiste mbi jargët e veta.

Stejsi me zor e mbajti të qeshurën.

- Kjo ka për të qenë e bukur.

Duke shpresuar ta dekurajojë, Kejti i hodhi një vështrim të zbrazët dhe i mblodhi vetullat me mospërfillje. *Syzja e diellit* nuk u përmbajt. Ai kërcëu përpjetë, duke u lëkundur sipas një ritmi muzikor që luhej vetëm në kokën e tij.

- Hej zogu, - tha *Syzja e diellit*, - mos e ke gjë emrin Wi-Fi?

Kejti po priste.

- Sepse po ndiej njëfarë lidhjeje.

Stejsi ia plasi së qeshurës.

Kejti vetëm po e shikonte ftohtë. Ai vazhdonte.

- Të dua shumë moj zoçkë e vogël, e di? Je e adhureshme. Je një flutur, e gjeta? E di ti se çfarë do të më shkonte mua për shtat? Ti.

- Punojnë ndonjëherë këto linjat? - e pyeti Kejti.

- Nuk kam mbaruar ende, - *Syzja e diellit* u kollit në grushtin e tij, nxori telefonin *iPhone* dhe e mbajti lart,

drejt Kejtit. - Hej, zogu, bravo, urime, sapo kalove në krye të listës së gjërave që kam për të bërë.

Stejsi po kënaqej.

Kejti i tha:

- Si e ke emrin?

Ai ngriti njëren vetull.

- Si të të pëlqejë ty, zogu.

- Si të duket emri, Kodosh? - Kejti hapi xhaketën e saj duke treguar armën që kishte në rrip. - Tani do të nxjerr pistoletën time, Kodosh.

- Të marrtë dreqi, grua, mos je gjë shefi im i ri? - ai tregoi me gisht pjesën mes kofshëve. - Sepse sapo ma ngrite.

- Zhduku!

- Dashuria ime për ty është si diarreja, - tha *Syzja e diellit*. - Nuk e mbaj dot.

Kejti e pa ftohtë, e tmerruar.

- Shkova shumë larg? - tha ai.

- Oh, shoku, është shumë e neveritshme!

- Po, por unë vë bast se ti s'ia ke dëgjuar zërin asnjëherë më parë këtij.

Bast i fituar.

- Ik. Tani.

- Vërtet?!

Stejsi ishte pothuajse e shtrirë në dysHEME nga të qeshurat.

Syzja e diellit filloi të largohet.

- Prit. Testim është ky? Kjo fjala, Kodosh, është ndonjë lloj komplimenti, a diçka e tillë?

- Qërohu!

Ai ngriti supet, u kthye, vuri re Stejsin, mendoi me vete, pse jo. Pa trupin e saj të gjatë nga lart-poshtë dhe tha:

- Fjala e ditës është këmbë. Shkojmë në shtëpinë tënde dhe të shohim nëse i hapim.

Stejsi po vazhdonte të argëtohej ende.

- Më merr mua, Kodosh. Këtu. Tani.

- Vërtet e ke?

- Jo.

Kodoshi e ktheu vështrimin te Kejti. Kejti vuri dorën në qytën e armës së saj. Ai i ngriti duart lart dhe iku vjedhurazi.

- Stejsi? - tha Kejti.

- Hëm?

- Pse këta djem vazhdojnë të mendojnë se mund të kenë ndonjë shans me mua?

- Sepse ti dukesh tërheqëse dhe plot gjallëri.

- Nuk jam plot gjallëri.

- Jo, por dukesh plot gjallëri.

- Seriozisht, dukem shumë si humbameno?

- Ti dukesh e lënduar, - tha Stejsi. - S'e dua veten që po ta them këtë. Por lëndimi... çlirohet nga ti si ndonjë lloj feromoni, të cilit trapat s'mund t'i rezistojnë.

Të dyja pinë nga një gllënjë pije.

- Atëherë, çfarë ishte ajo gjëja që nuk do të më pëlqente mua? - pyeti Kejti.

Stejsi hodhi vështrimin pas, në drejtim të Kodoshit.

- Tani po më vjen keq për të. Ndoshta do të më duhet t'i propozoj të bëjmë ndonjë të shpejtë.

- Mos e bëj.

- Çfarë? - Stejsi kryqëzoi këmbët e saj të gjata që binin në sy dhe i buzëqeshi Kodoshit. Ai e bëri fytyrën në një mënyrë të tillë që i kujtoi Kejtin një qen të lënë në makinë për shumë kohë. - Mendon se këtë fundin e kam shumë të shkurtër?

- Fund? - tha Kejti. - Unë mendova se ishte rrip.

Stejsit i pëlqeu kjo. Asaj i pëlqente të tërhiqte vëmendjen. Vdiste të gjuante burra, sepse mendonte që po të kalonin një natë me të, do të ishte në njëfarë mënyre ndryshim i jetës për ta. Edhe kjo ishte pjesë e punës së saj. Stejsi kishte një kompani private hetimi me dy gra të tjera shumë të bukura. Specialiteti i tyre? Të gjuanin (në fakt, të fusnin në grackë) bashkëshortë që tradhtonin.

- Stejsi?

- Hëm?

- Çfarë nuk do të më pëlqente mua?

- Kjo.

Duke vazhduar të tallej me Kodoshin, Stejsi i zgjati Kejtin një copë letër. Kejti e pa letrën dhe shfryu e vrenjtur:

KD8115

HottestSexEvah

- Ç'është kjo?

- *KD8115* është emri i përdoruesit për ty.

Inicialet e saj dhe numri i fletëhyrjes.

- *HottestSexEvah* është fjalëkalimi yt. Oh, edhe ki parasysh që ke germa të vogla dhe të mëdha.

- Po këto, për çfarë janë?

- Është një faqe në internet. *YouAreJustMyType.com*.

- Çfarë?

- Është një shërbim për takime *online*.

Kejti shtrembëroi fytyrën.

- Të lutem më thuaj që po bën shaka.

- Është e rangut të lartë.

- Kështu thonë ata kur flasin për klubet e striptizmit.

- Të kam bërë një abonim, - tha Stejsi. - Është i vlefshëm për një vit.

- Po bën shaka, apo jo?

- Nuk bëj shaka unë. Bëj disa gjëra për këtë kompani. Janë të mirë. Dhe s'ka përse ta mashtrojmë veten. Ti ke nevojë për dikë. Ty të duhet dikush. Dhe nuk ke për ta gjetur këtu atë që të duhet.

Kejti psherëtiu, u ngrit dhe i bëri shenjë me kokë banakierit, një djali që quhej Pete dhe që dukej si një aktor figurant, i cili luante gjithmonë rolin e banakierit irlandez - gjë që në fakt, ishte e vërtetë. Pete u përgjigj me një të tundur të kokës, duke treguar se do t'i vendoste pijet në llogarinë e saj.

- Kushedi? - tha Stejsi. - Mund të të vejë mbarë të gjesh Zotërinë e Duhur.

Kejti u nis drejt derës.

- Po, më shumë, ka të ngjarë të gjej Zotërinë Kodosh.

KEJTI shtypi në tastierë adresën *YouAreJustMyType.com*, i ra butonit *RETURN* dhe vuri emrin e vet dhe fjalëkalimin shumë të sikletshëm. Psherëtiu kur e pa nofkën në krye të profilin që i kishte zgjedhur Stejsi:

E këndshme dhe plot gjallëri!

- Ka harruar e *lënduar*, - mërmëriti Kejti nën zë.

Kishte kaluar mesi i natës, por Kejti nuk ishte shumë e dhënë pas gjumit. Jetonte në një zonë të nivelit shumë të lartë përtë, *West 67th Street off Central Park West*, në një ndërtesë të mbiquajtur *Atelier*. Njëqind vite më parë, kjo dhe ndërtesat ngjitur me të, përfshirë të famshmin “Hôtel des Artistes” (Hoteli i Artistëve) kishin strehuar shkrimtarë, piktorë, intelektualë, artistë. Apartamentet e bollshme të botës së vjetër shikonin nga rruga, studiot më të vogla të artistëve ishin nga mbrapa. Më vonë, studiot e vjetra të artit ishin kthyer në apartamente me një dhomë gjumi. Babai i Kejtit, një polic, i cili i shikonte shokët e vet që po bëheshin të pasur duke mos bërë asgjë tjetër veç shitblerjes së pasurive të paluajtshme, u përpoq ta gjente veten aty. Një djalë, të cilit i ati i kishte shpëtuar jetën, ia shiti këtë vend me çmim të lirë.

Kejti e kishte përdorur atë fillimisht kur ishte studente në “Columbia University”. E kishte paguar shkollimin e saj në “Ivy League” me një bursë të NYPD-së. Sipas planit, që kishte për jetën, supozohej që më vonë të vazhdonte shkollën për juridik dhe të fillonte punë në ndonjë nga studiot e mëdha të avokatëve, këpucëve të bardha, në qytetin e Nju-Jorkut, duke u shkëputur njëherë e mirë nga tradita familjare e mallkuar e punës së policit.

Mjerisht, nuk kishte ndodhur kështu.

Një gotë me verë të kuqe rrinte pas tastierës së saj. Kejti pinte shumë. E dinte që kjo ishte klishe - një polic që pinte shumë - por ndonjëherë klishetë kanë arsye. Ajo e përmbante veten shumë mirë. Nuk pinte në punë. Kjo gjë, në fakt, nuk ndikonte në jetën e saj të dukshme, por në qoftë se Kejti bënte telefonata ose merrte vendime natën vonë, ato kishte të ngjarë që të ishin të paqarta. Gjatë viteve kishte mësuar të fikte celularin dhe të qëndronte larg *email*-eve pas orës dhjetë të natës.

Por, ja ku ishte tani, natën vonë, duke kontrolluar për ndonjë tip të rastësishëm në një faqe interneti për takime.

Stejsi kishte hedhur katër fotografi në faqen e Kejtit. Fotografia e profilit të Kejtit, që të binte në kokë, ishte prerë nga fotografia e grupit të shoqërueseve të nuses në një dasmë të vitit të kaluar. Kejti provoi ta shihte veten me objektivitet, por ishte e pamundur. E urrente atë fotografi. Gruaja në fotografi dukej e pasigurt për veten, me një buzëqeshje të vakët, pothuajse sikur po priste t'i jepnin një shuplakë. Çdo fotografi - tani që ajo kishte hyrë në ritualin e dhimbshëm të shikimit të tyre - ishte prerë nga fotografi të bëra në grup dhe në secilën prej tyre Kejti dukej sikur ishte e prerë në mes.

Okej, mjaft me fotografitë e profilit të saj.

Në punë, burrat e vetëm që takonte ajo ishin policë. Ajo nuk donte një polic. Policët ishin njerëz të mirë dhe bashkëshortë të tmerrshëm. E dinte shumë mirë këtë. Kur gjyshja e saj u sëmur rëndë, gjyshi, i cili nuk

mundi ta përballonte dot sëmundjen e saj, u largua dhe nuk ia fali kurrë vetes këtë veprim. Megjithatë, kjo ishte teoria e Kejtit. Ishte i vetmuar dhe ndërkohë kishte qenë hero për shumë njerëz. Gjyshi doli në pension atëherë kur puna i duhej më shumë dhe pa të cilën nuk mund të jetonte. Pistoleta e tij e shërbimit rrinte atje, në majë të të njëjtit raft në kuzhinë, ku ai e kishte mbajtur gjithmonë dhe kështu, një natë gjyshi i Kejtit e kapi dhe e mori copën e hekurit nga rafti, u ul i vetëm në tavolinën e kuzhinës dhe...

Bu-uum.

Në atë kohë edhe babai i saj donte të shkonte të bëhej tapë e të zhdukej për ditë me radhë. Mamaja gëzohej shumë kur ndodhte kjo, gjë e cila e bënte situatën gjithnjë e më të frikshme dhe të mërzitshme. Ajo pretendonte se babai ishte në një mision të pazbuluar ose e shpërfillte plotësisht zhdukjen e tij, në kuptimin e plotë të fjalës larg syve larg mendjes, dhe, më pas, ndoshta edhe një javë më vonë, babai do të vinte duke vallëzuar, i rruar taze, duke buzëqeshur, me një duzinë trëndafila për mamane dhe të gjithë do të silleshin sikur kjo të ishte normale.

YouAreJustMyType.com. Ajo, Kejt Donovan, e këndshme dhe plot gjallëri, ishte në një faqe takimesh në internet. Edhe tani miku im, le të flasim për planet tona më të mira. Ajo ngriti gotën e verës, duke bërë me gjest një dollë drejt ekranit të kompjuterit dhe gëlltiti një gllënjë të madhe.

Për fat të keq, bota nuk ishte më vendi i favorshëm për të takuar shokun e jetës. Seksi, nuk ishte problem.

Në fakt të gjithë e kërkonin pa e pohuar, por Kejti, megjithatë, nuk bënte të ndershten, dhe e dinte se kur shkon shpejt në shtrat me dikë, mundësia për një marrëdhënie afatgjatë merr një goditje të fortë. Nuk ishte një gjykim moral. Ishte tamam kështu, asgjë më shumë.

Kompjuteri i saj tringëlli. Një mesazh u shfaq:

Kemi gjetur dikë që të përshtatet! Kliko këtu për të parë dikë që mund të jetë i përsosur për ty!

Kejti mbaroi gotën e verës. Po bluante në mendje që të pinte edhe një tjetër, por më mirë mjaft. Zuri vend, u rehatua dhe po mendonte për një të vërtetë të qartë, që s'ia kishte thënë vetes ende: kishte nevojë për dikë në jetën e saj. Ki kurajën t'ia pohosh vetes këtë gjë, dakord? Po aq shumë sa përpiquej të ishte e pavarur, Kejti donte të kishte një mashkull, një partner, dikë për të ndarë shtratin netëve. Ajo nuk ishte e djegur për burrë, dhe as nuk detyronte njeri, apo të bënte ndonjë përpjekje të madhe. Por, në të vërtetë, nuk ishte tipi i lindur për të jetuar e vetme.

Filloi të klikonte nëpër profile. Duhet të hysh në lojë që të fitosh, apo jo?

Për të qarë hallin.

Disa burra duheshin eliminuar që me shikimin e parë të fotografisë së tyre të profilit. Kjo ishte pikë kyçe kur mendoje për të. Fotografia e profilit, që çdo burrë e kishte përzgjedhur me shumë kujdes, në shumicën e rasteve ishte përshtypja e parë (shumë

e kontrolluar). Ajo fliste aq sa për të mbushur vëllime të tëra.

Prandaj, nëse zgjidhje të mbaje me ndërgjegje një kapelë republikë, ishte një përgjigje automatike jo. Nëse zgjidhje një fotografi ku ke dalë me gjoksin jashtë, pavarësisht se sa trup të rregullt mund të kishe, automatikisht jo. Në qoftë se kishe një *Bluetooth* në vesh - heej, nuk je i rëndësishëm *ti?* - automatikisht jo. Në qoftë se kishe një cullufe të parruar nën buzën e poshtme ose një jelek sportiv, apo nëse shkelje syrin ose bëje gjeste me duar, apo nëse kishe një këmishë ngjyrëmandarine (paragjykim personal) ose po t'i kishe vënë syzet e diellit në majë të kokës, automatikisht jo, jo, jo. Në qoftë se emri i profilin tënd ishte Mashkull-Hamshor, Buzëqeshje Seksi, Bukurosh i Pasur, Përmbushës i Zonjave, e ke të qartë kuptimin.

Kejti hapi profilet duke klikuar disa nga ato ku djali dukej... i pranueshëm, siç e mendonte ajo. Të gjitha prezantimet kishin një ngjashmëri depressive, të trishtuar. Çdo personi në atë faqe interneti, i pëlqente të shëtiste në breg të detit, të hante darkë jashtë, të bënte gjimnastikë, udhëtime ekzotike, të shijonte verërat, teatrot e muzetë, të ishte aktiv dhe të merrte rrezikun në sy e të bënte aventura të mëdha, për më tepër, ata ishin njësoj të kënaqur duke ndenjur në shtëpi e duke parë filma në televizor, duke pirë kafë e duke biseduar, duke gatuar, duke lexuar libra e duke u kënaqur me gjëra të thjeshta. Të gjithë djemtë pretendonin se cilësia më e madhe, të cilën ata kërkonin te një grua, ishte sensi i

humorit, pra dakord, patjetër sipas hamendësimeve të Kejtit “sensi i humorit” ishte një eufemizëm për “cica të mëdha”. Sigurisht, çdo mashkull i vinte me radhë edhe llojet e trupit që pëlqente, si atletike, elegante dhe me forma të lakuara.

Kjo dukej si më e sakta, nëse nuk ishte dëshirë e çiltër.

Profilet asnjëherë nuk pasqyronin realitetin. Në vend që të ishin ashtu siç jeni në të vërtetë, ato ishin një ushtrim i mrekullueshëm, nëse jo i kotë, në atë që mendoni se jeni ose çfarë doni ju që të mendojë një partner i mundshëm se jeni ose, ka më shumë të ngjarë, profilet (dhe, shoku, që ta bësh shkurtimisht, të duhet një ditë e tërë) vetëm sa pasqyrojnë atë çka dëshironi të jeni.

Deklarata personale kishte gjithandej, por në qoftë se ajo do të donte t’i përmbledhte vetëm me një fjalë, ndoshta ajo fjalë do të ishte *të sheqerosura*. Leximi i parë, “Çdo mëngjes, jeta është një kanavacë e bardhë që pret të pikturohet”, klik. Disa përpiqeshin të tregoheshin të ndershëm duke e thënë disa herë që ishin të ndershëm. Një sinqeritet i shtirë. Disa ishin pompozë, njerëz që kërkonin të binin në sy, të pasigurt ose varfanjakë. Njësoj si në jetën reale, kur Kejti mendonte për ta. Një pjesë e mirë prej tyre ishin me të vërtetë duke u përpjekur shumë. Duhma e ndyrë e dëshpërimit vinte që nga ekranit me aromën e çuditshme të një kolonje të keqe. Biseda konstante për shpirtin binjak, ishte, në rastin më të mirë, e pavend. Në

jetën reale, Kejti mendonte se askush nuk mund të gjente dikë me të cilin të kishte dëshirë të dilte më shumë se një herë, pale të besojë se, në njëfarë mënyre, në faqen *YouAreJustMyType.com* mund të gjeje menjëherë një person me të cilin do të doje të zgjoheshe nga gjumi pjesën tjetër të jetës.

Zhgënjyese, apo ka shpresë për pranverë të përjetshme?

Kjo ishte ana tjetër e medaljes. Ishte shumë e thjeshtë të ishe cinike dhe thumbuese, por kur ndaloj për një moment, Kejti pati ndjesinë e diçkaje që e shpoi drejt e në zemër: çdo profil ishte një jetë. E thjeshtë, po, por pas çdo klisheje të kaluar, profili “të lutem, më pëlqe mua” ishte një qenie njerëzore, me ëndrra, me aspirata dhe me dëshira. Këta njerëz nuk ishin regjistruar, nuk kishin paguar tarifën, apo plotësuar këtë informacion, kot së koti. Pa mendo pak për këtë gjë: cilido nga këta njerëz të vetmuar ka ardhur në këtë faqe interneti, duke u futur aty dhe duke klikuar nëpër profile, duke shpresuar se këtë herë do të ishte ndryshe, duke shpresuar kundër çdo shprese se më në fund ata do të mund të takonin personin e vetëm, i cili, përfundimisht, do të ishte personi më i rëndësishëm në jetët e tyre.

Uau. Vetëm lëreni këtë ndjesi të sillet përqark jush për një moment.

Kejti kishte humbur në mendimet e saj, duke klikuar nëpër profile me një shpejtësi që sa vinte e rritej, në fytyrat e këtyre burrave, burra që kishin ardhur këtu me shpresën për të gjetur “njërën”, kur,

e turbulluar nëpër rrëmujën e trupave, papritur, ajo dalloj fytyrën e tij.

Për një sekondë, ndoshta për dy, truri i saj nuk po e besonte atë që po i shikonin sytë. Iu desh edhe një sekondë tjetër që gishti të ndalonte së shtypuri butonin e mausit, edhe një tjetër që fotografitë e profilin, që po binin, të ngadalësoheshin dhe më në fund të ndalonin. Kejti ndaloj dhe mori frymë thellë.

Nuk mund të ishte ai.

Ajo ishte duke u endur me një ritëm të shpejtë, duke menduar për meshkujt mbrapa fotografive, jetët e tyre, dëshirat e tyre, shpresat e tyre. Mendja e saj, që ishte forca dhe dobësia e Kejtit si police, kishte qenë e përhumur, jo duke u përqendruar domosdo në atë që ishte përballë saj, por që të krijonte një përshtypje për fotografinë e madhe, atë të realitetit. Në zbatimin e ligjit, kjo do të thoshte se ajo ishte në gjendje t'i shikonte të gjitha mundësitë, rrugët e shpëtimit, planet alternative të veprimit, figurat e fshehura mbrapa pengesave, shkëputjen e ndërlikohjes, bllokimet dhe mashtrimet.

Por kjo do të thoshte gjithashtu se, ndonjëherë, Kejti nuk ishte e qartë.

Ngadalë filloi të klikojë me shigjetën e kthimit mbrapa.

Nuk kishte mundësi të ishte ai.

Imazhi nuk ishte asgjë më shumë se një flakërimë. Gjithë ato mendime për dashurinë e vërtetë, për shpirtin binjak, për personin e vetëm me të cilin ajo do mund të donte të kalonte jetën, kush mund ta fajësonte

fantazinë e saj për të shkruar nëpër mend gjërat më të bukura? Kishin kaluar tetëmbëdhjetë vjet. Ajo e kishte kërkuar në *Google* disa herë, kur kishte qenë e dehur, por atje kishte gjetur vetëm pak artikuj të vjetër që kishte shkruar ai. Asgjë aktuale. Ajo që e kishte befasuar, i kishte ndezur kureshtjen. Xhefi kishte qenë një gazetar shumë i mirë, por çfarë mund të bënte ajo më shumë? Kejti kishte tentuar të fillonte një hetim më të hollësishëm për të. Nuk do të ishte një gjë shumë e ndërlikuar, por asaj nuk i pëlqente të përdorte për nevoja personale lidhjet që kishte në zbatim të ligjit. Ajo edhe mund ta kishte pyetur Stejsin, por përsëri, cila do të ishte arsyeja?

Xhefi kishte ikur.

Ndjekja, apo qoftë edhe kërkimi në *Google* i një ishte dashuri, ishte përtej patetizmit. Okej, Xhefi kishte qenë më shumë se kaq. Shumë më shumë. Kejti, pa e pasur mendjen preku gishtin e majtë të unazës me gishtin e madh. Bosh. Por nuk kishte qenë gjithnjë ashtu. Xhefi i kishte propozuar, duke e bërë çdo gjë si duhej. I ulur mbi njërin gju. Kishte marrë edhe leje nga babai i saj. Asgjë e pakëndshme. Ai nuk e kishte fshehur unazën në ndonjë ëmbëlsirë apo t'i propozonte asaj duke shkarravitur në tabelën e pikëve në *Madison Square Garden*. Kishte qenë klasik, romantik dhe tradicional, sepse e dinte që ashtu ishte tamam si do ta donte ajo.

Lotët filluan t'i rridhnin nga sytë.

Kejti klikoi shigjetën e kthimit nëpër një potpuri fytyrash dhe modele flokësh, ku gjendeshin beqarë të pranueshëm nga të gjitha kombet e bashkuara të

vërteta beqarësh, derisa gishti i saj ndaloj. Për një moment, mbeti e habitur, pati frikë të lëvizte; mbajti frymën.

Pastaj i shpëtoi nga buzët një britmë e vogël.

Brenga e vjetër e zemrës iu kthye me shpejtësi. Sëmbimi i thellë i dhimbjes u ndje i freskët, a thua se Xhefi sapo kishte dalë nga dera, tani, në këtë sekondë dhe jo tetëmbëdhjetë vjet më parë. I dridhej dora duke e zgjatur në drejtim të ekranit dhe e preku fytyrën e tij.

Xhefi.

Vazhdonte të ishte po aq i pashëm. Ishte plakur paksa, sigurisht, flokët te tëmthet kishin filluar t'i zbardheshin, por, shoku, i shkonin shumë. Kejt i duhet ta kishte marrë me mend këtë gjë. Xhefi do të ketë qenë një nga ata burra që me kalimin e moshës sa vinë e bëhen më të mirë. E përkëdheli fytyrën e tij. Në cepin e njërit sy i shkëlqeu një lot i vetmuar.

- Oh, Zot, - mendoj ajo.

Kejt i mundua ta kujtonte veten bashkë me të, u përpoq të kthehet një hap prapa për të menduar në njëfarë perspektive, por dhoma po i rrotullohej dhe nuk kishte asnjë mënyrë për ta ndaluar atë. Dora e saj, që vazhdonte të tundej, u kthye mbrapa te mausi dhe klikoi te fotografia e profilit, e zmadhoi.

Ekрани kaloi në faqen tjetër. Atje Xhefi qëndronte në këmbë, i veshur me një triko dhe me xhinse, me duart në xhepa, me sytë aq blu, sa do të kërkoje kot për të gjetur ndonjë shenjë të lenteve të kontaktit. Kaq i pashëm. E marrtë dreqi, sa i bukur ishte.

Dukej i rregulluar dhe sportiv edhe tani, pavarësisht të gjithave, një trazim tjetër filloi thellë brenda saj. Për më pak se një sekondë, Kejti hodhi një vështrim vjedhurazi në dhomën e saj të gjumit. Kishte jetuar në këtë apartament kur kishin qenë bashkë. Pas tij, në atë dhomë gjumi, kishin qenë edhe meshkuj të tjerë, por asnjëherë dhe askush nuk kishte mundur të afrohej aq sa ajo ishte afruar dhe kishte përjetuar me ish-të fejuarin e saj. Ajo e dinte si dukej kjo tani, por kur kishte qenë me Xhefin, ai e kishte bërë çdo pjesë të saj të gumëzhinte dhe të këndonte. Nuk ishte as teknika, as madhësia dhe asgjë tjetër e tillë që përbënte ndryshimin. Nuk ishte çështje eksperience erotike, ishte çështje besimi. Kjo gjë e kishte bërë seksin që të të luanin mendtë e kokës. Kejti ishte ndier e sigurt me të. Ishte ndier e sigurt, e bukur, e patrembur dhe e lirë. Ai e ngacmonte ndonjëherë, e kontrollonte, bënte ç't'i donte qejfi me të, por ai asnjëherë nuk e kishte bërë të ndihej e rrezikuar apo e turpëruar.

Kejti nuk kishte qenë më në gjendje të kalonte situata të tilla me ndonjë burrë tjetër. Ajo u gëlltit dhe klikoi linkun e profilit të plotë. Përshkrimi ishte i shkurtër, shumë mirë, mendoi Kejti.

Bëj atë që duhet të bësh.

Pa presion. Pa plane madhështore. Pa kushte paraprake, pa garanci apo pritshmëri të egra.

Bëj atë që duhet të bësh.

Ajo rrëshqiti në drejtim të seksionit të statusit. Gjatë tetëmbëdhjetë viteve të shkuara, Kejti kishte imagjinuar pafundësisht se ç'drejtim kishte marrë

jeta e tij, prandaj, pyetja e parë ishte ajo më e qarta: çfarë kishte ndodhur me jetën e Xhefit, që ai kishte përfunduar në një faqe interneti për beqarët?

Edhe njëherë, çfarë po i ndodhte asaj?

Në status shkruhej: I ve.

Edhe një uau tjetër.

Ajo u përpoq të përfytyronte se Xhefi ishte martuar me një grua, kishte jetuar me të, e kishte dashur dhe, më pas, ajo kishte vdekur. Këtë nuk e llogariste dot. Ende jo. Ishte e bllokuar. Kjo ishte në rregull. Vazhdo ende. Nuk kishte arsye pse të kërkonte akoma aty.

I ve.

Poshtë kësaj, një e shkundur tjetër: Një fëmijë.

Nuk jepej mosha ose seksi dhe, sigurisht, kjo nuk kishte rëndësi. Çdo zbulim, çdo fakt i ri për burrin, të cilin e kishte dashur me gjithë forcën e shpirtit, e bënte botën të lëkundej sërish. Ai kishte jetuar një jetë të tërë pa të. Pse duhej të ishte e papritur tani? Çfarë kishte pritur ajo? Prishja e tyre kishte qenë e menjëhershme dhe e pashmangshme. Mund të ishte ai që ishte larguar, por sidoqoftë kjo kishte ndodhur për faj të saj. Ai kishte ikur, ishte zhdukur, si gjithë jeta që ajo kishte bërë dhe planifikuar të bënte.

Tani ai ishte kthyer, ishte një nga njëqind, ndoshta dyqind, meshkujt në profilet e të cilëve ajo kishte klikuar.

Pyetja ishte: çfarë do të bënte ajo tani?!

2

PAK orë para se Gerard Remingtoni t'i kërkonte dorën për martesë Vanesa Morautit, bota e tij u përmbys.

Propozimi, njësoj si shumë gjëra në jetën e Gerard Remingtonit, ishte i planifikuar me kujdes. Hapi i parë: pas kërkimeve të shumta, Gerardi kishte blerë një unazë fejese, 2.93 karat, model princeshe, me qartësi VVS1, ngjyrë F, platin në formë rrethi me diamante të vogla përqark. E kishte blerë atë nga një argjendar i famshëm te Rrethi i Diamanteve të Manhatanit, në rrugën *West 47th Street*, jo në ndonjë nga dyqanet e mëdha me çmime të kripura, por në një kioskë nga mbrapa, afër qoshes së rrugës *Sixth Avenue*.

Hapi i dytë: fluturimi i tyre sot duhej të niste nga aeroporti *Logan* i Bostonit, me fluturimin *JetBlu 267* në orën 7:30 të mëngjesit, për t'u ulur në *St. Maarten* në orën 11:31 paradite, ku bashkë me Vanesën do të

shkonin me një aeroplan të vogël në Anguilla, ku do të mbërrinin në orën 12:45 pasdite.

Hapat tre-katër etj.: ata do të çlodheshin në vilën dykatëshe në Viceroy me pamje nga Meads Bay, do të zhyteshin në pishinën e stërmadhe, do të bënin dashuri, do të laheshin e do të visheshin dhe do të dilnin për darkë në restorantin *Blanchard's*. Rezervimi i darkës ishte bërë për në orën shtatë pasdite. Gerardi kishte telefonuar më përpara dhe kishte porositur të merrte një shishe nga vera e preferuar e Vanesës, një *Château Haut-Bailly Grand Cru Classé 2005*, nga zona me emrin *Pessac-Leognan*, çdo gjë gati. Pas darkës, Gerardi dhe Vanesa do të ecnin zbathur në plazh, të kapur për dore. Ai kishte kontrolluar kalendarin e fazës hënore dhe e dinte se hëna do të ishte pothuajse e plotë në atë kohë. Afërsisht 200 metra përgjatë plazhit, ishte një barakë e mbuluar me kashtë, që përdorej gjatë ditës për të dhënë me qira maska për zhytje dhe ski uji. Gjatë natës, aty s'kishte njeri. Një luleshitës vendas kishte bërë përpara hyrjes një vijë me njëzet e një, aq sa numri i javëve që ata ishin njohur me njëri-tjetrin, zambakë të bardhë, lulja e preferuar e Vanesës. Atje duhet të ishte edhe një kuartet harqesh, gjithashtu. Me sugjerimin e Gerardit kuarteti do të luante këngën *Somewhere Only We Know* (*Diku ku vetëm ne e dimë*) nga Keane, këngë për të cilën ai dhe Vanesa kishin vendosur se do të ishte përgjithmonë e tyrja. Pastaj, meqë të dy i pëlqenin gjërat tradicionale, Gerardi do të përkulej në njërin gju. Me sytë e mendjes, Gerardi pothuajse e shikonte

reagimin e Vanesës. Ajo do të hapte gojën e befasuar. Sytë e saj do të njomeshin nga lotët. Ajo do ta fshilte fytyrën me duar nga mahnitja dhe gëzimi.

- Ti hyre në botën time dhe e ndryshove përgjithmonë, - do t'i thoshte Gerardi. - Si katalizatori më mahnitës, ti e more këtë copë balte të zakonshme dhe e shndërrove në diçka shumë më të fuqishme, shumë më të lumtur dhe të mbushur plot me jetë, aq sa unë nuk e kisha imagjinuar kurrë. Të dua. Të dashuroj me gjithë qenien time. Dashuroj çdo gjë që ka të bëjë me ty. E qeshura jote i jep ngjyrë dhe formë jetës sime. Ti je gruaja më e bukur dhe më e pasionuar në botë. Të lutem, do që të më bësh burrin më të lumtur në botë dhe të martohesh me mua?

Gerardi ishte ende duke përpunuar formulimin e saktë, sepse donte që të ishte gjëja e duhur, kur papritur bota e tij u nxi. Por çdo fjalë ishte e vërtetë. Ai e dashuronte Vanesën. E dashuronte me gjithë zemër. Gerardi asnjëherë nuk kishte qenë kaq shumë romantik. Gjatë gjithë jetës së tij njerëzit kishin qenë të prirë për ta zhgënjyer. Shkenca nuk ishte kështu. Për hir të së vërtetës, ai gjithmonë kishte qenë më i kënaqur të jetonte vetëm, duke luftuar me mikrobet, duke punuar për ilaçe dhe antiserume të reja, të cilat do ta lejonin t'i fitonte ato beteja. Kishte qenë shumë i kënaqur në laboratorin e tij, në Benesti Pharmaceuticals, kur kishte zbuluar një ekuacion ose formulë në dërrasën e zezë. Ai ishte, si do të thoshin kolegët e tij më të rinj, me mënyrat e shkollës së

vjetër. I pëlqente dërrasa e zezë. Ajo e ndihmonte që të mendohej, i pëlqente aroma e shkumësit, pluhuri, mënyra se si bëheshin pis gishtat, lehtësia e fshirjes, sepse në shkencë, në fakt, asgjë nuk zgjat me të vërtetë përgjithmonë.

Po, dërrasa e zezë ishte atje në ato momente të humbura vetmie, kur Gerardi ndihej më i kënaqur.

Shumë i kënaqur, por jo i lumtur.

Vanesa kishte qenë gjëja e parë në jetën e tij që e kishte bërë të lumtur.

Gerardi i hapi sytë dhe po mendonte për të. Çdo gjë ishte ngritur në fuqi të dhjetë me Vanesën. Asnjë grua tjetër nuk e kishte prekur atë ndonjëherë mendërisht, emocionalisht dhe po, patjetër, fizikisht si Vanesa. Asnjë grua tjetër, që ai kishte njohur, nuk kishte mundur.

Ai i hapi sytë dhe ende kishte mbetur errësira. Në fillim mendoi se ishte diku në shtëpinë e vet, por ishte shumë më ftohtë. E mbante termostatin digjital në një temperaturë afërsisht 22° C. Vanesa shpeshherë e ngacmonte për përpikërinë e tij. Gjatë jetës së tij, disa njerëz e kishin konsideruar nevojën e Gerardit për rregullsi pothuajse si fiksion ose edhe si OCD (Obsessive Compulsive Disorder). Vanesa, gjithsesi e kuptonte dhe e vlerësonte atë gjë, po e konsideronte edhe si bonus. “Kjo është ajo që të bën një shkencëtar të madh dhe një njeri të dashur”, i kishte shkruar njëherë Vanesa. Ajo ia shpjegoi atij teorinë e vet, se njerëzit, që sot konsiderohen si të prekur nga shqetësimet e spektrit autistik, në të kaluarën kanë qenë gjeni të

artit, shkencës dhe literaturës, ndërsa tani, mjekimet dhe diagnozat kanë tendencë të fshijnë veçoritë e tyre, duke i bërë ata më të njëtrajtshëm, duke mpirë shqisat e tyre.

- Gjenitë vijnë nga e pazakonta, - i kishte shpjeguar Vanesa.

- Dhe unë jam i pazakontë?

- Në mënyrën më të mirë të mundshme, i dashur.

Por, ndërkohë që zemra e tij mbushej nga kujtimet, Gerardi nuk kishte sesi të mos e ndiente aromën e çuditshme. Diçka të lagësht, të vjetër, të mykur dhe si...

Si të qelbur. Si dhé i freskët.

Menjëherë e kapi paniku. Ende në mes të errësirës, Gerardi u përpoq ta ngrinte dorën në fytyrë. Nuk e bënte dot. Kishte diçka që ia kishte lidhur kyçet e duarve. Dukej si litar apo, jo, diçka më e imët. Ndoshta ishte tel. Ai u përpoq t'i lëvizte këmbët. Ato ishin të lidhura bashkë. Ai mblodhi muskujt e barkut dhe u përpoq të lëvizte të dyja këmbët në ajër, por ato goditën diçka. Diçka të drunjtë. Tamam sipër tyre. Sikur ai të ishte në...

Trupi i tij filloi të hidhej nga frika.

Ku ishte ai? Ku ishte Vanesa?

- Ej? - bërtiti ai. - Ej?

Gerardi u përpoq të ngrihej, por edhe përqark krahavorit të tij ishte një rrip. Ai nuk mund të lëvizte. Po priste që sytë t'i mësoheshin me errësirën, por kjo gjë nuk po ndodhte aq shpejt sa duhej.

- Ej? Ka njeri? Ju lutem, më ndihmoni!

Tani ai dëgjoi një zhurmë. Tamam sipër vetes.
Dëgjohej si gërryerje a zvarritje këmbësh ose...

Ose zhurmë hapash?

Zhurmë hapash tamam sipër tij.

Gerardi po mendonte për errësirën. Po mendonte
për aromën e dheut të freskët. Përgjigjja u bë
menjëherë e qartë, por ajo nuk kishte kuptim.

Jam nën tokë, mendonte ai, jam nën tokë.

Dhe pastaj filloi të bërtasë.

3

KEJTI doli jashtë më shumë se e përgjumur.

Ashtu si bënte çdo ditë të javës, alarmi i *iPod*-it të saj e ngriti me një këngë të rastësishme nga ato të preferuarat e saj, këtë mëngjes, në orën gjashtë, ishte *Bulletproof Weeks (Javë Antiplumb)* nga Matt Nathanson. Nuk i kishte dalë nga mendja që kishte rënë në gjumë në krevatin ku kishte fjetur me Xhefin gjithë ato vite të shkuara. Dhoma e kishte ende veshjen me dërrasa të errëta. Pronari i mëparshëm kishte qenë violinist në Filarmoninë e Nju-Jorkut. Ai kishte vendosur ta bënte gjithë apartamentin, afërsisht 56 m², të dukej si brendia e një anijeje të vjetër. Ishte i gjithi me dru të errët dhe me frëngji në vend të dritareve. Ajo dhe Xhefi kishin qeshur, duke luajtur si budallenj, me nënkuptime, duke bërë sikur anija lëkundej, përmbysëj apo thërrisnin për një varkë shpëtimi; si t'u vinte për mbarë.

Dashuria e bënte mërzitjen disi pikante.

- Ky vend, - do të thoshte Xhefi, - nuk ka asnjë lidhje me ty.

Sigurisht, ai e shikonte të fejuarën e tij studente si më të çelur dhe më të hareshme nga mjedisi që e rrethonte, por tani, tetëmbëdhjetë vjet më vonë, kushdo që hynte në banesën e saj mendonte se ai vend i përshtatej Kejtit më së miri. Ashtu si dy bashkëshortë që me kalimin e viteve fillojnë të ngjasin me njëri-tjetrin, ajo kishte filluar t'i ngjante këtij apartamenti.

Kejti hezitoi të qëndronte akoma në shtrat dhe të merrte një sy gjumë, por kursi do të fillonte pas pesëmbëdhjetë minutash. Instruktori i saj, Akua, një transvestit i imët me çrregullim skizofrenik të personalitetit, për mungesat në kurs, nuk pranonte asgjë tjetër përveç justifikimeve për kërcënimin e jetës. Përveç kësaj, Stejsi mund të ishte atje dhe Kejti shpresonte që të fliste me të për historinë e Xhefit, që e rigjeti në atë faqen e internetit. Kejti veshi pantallonat e saj të jogës dhe kanotierën, rrëmbeu një shishe ujë dhe u drejtua për nga dera. Vështrimi i saj u tërhoq nga kompjuteri që ishte mbi tavolinë.

Ah, ç'të keqe kishte, po t'i hidhte një sy të shpejtë?

Faqja e hyrjes së *YouAreJustMyType.com*, ishte ende e hapur, megjithëse llogaria e saj ishte mbyllur pas dy orësh mosaktivizimi. Ata kishin nxjerrë një "ofertë interesante hyrëse" për "Të porsaardhurit" (kush tjetër do të ishte i përshtatshëm për një ofertë hyrëse?), një muaj akses të pakufizuar për çfarëdolloj gjëje vetëm për 5.74 dollarë "të faturuar në fshehtësi"

(hë?) në kartën tuaj të kreditit. Për fatin e mirë të Kejtit, Stejsi tashmë i kishte blerë asaj një vit të tërë. Urraaa!

Kejti vendosi emrin dhe fjalëkalimin e saj përsëri në fushat e duhura dhe shtypi *RETURN*. Aty ishin mesazhet e tanishme nga meshkuj. Ajo i shpërfilli. E gjeti faqen e Xhefit, sigurisht që e kishte bërë *bookmark*.

Klikoi butonin *REPLY*. Gishtat i mbetën mbi tastierë. Çfarë duhet t'i thoshte?

Asgjë. Gjithsesi, jo tani. Duhet të mendohej për të. Koha po ikte. Kursi ishte duke filluar. Kejti shkundi kokën, u ngrit dhe u drejtua për te dera. Njësoj si bënte çdo të hënë, të mërkurë dhe të premte, Kejti vrapoi përmes *Rrugës 72* dhe hyri në *Central Park*. Kryetari i bashkisë së *Strawberry Fields*-it, një artist performues, që jetonte me bakshishet e turistëve, tashmë i kishte vendosur lulet e tij në mozaikun e përmendores *Imagine* në nder të Xhon Lenonit (John Lennon). E bënte këtë pothuajse çdo ditë, por rrallëherë dilte kaq shpejt.

- Hej, Kejt, - tha ai duke i dhënë asaj një trëndafil. Ajo e mori.

- Mirëmëngjesi, Geri.

Kaloi me nxitim tarracën e sipërme të *Bethesda*-s. Liqeni ishte ende i qetë, s'kishte dalë asnjë varkë, por uji që rridhte nga shatërvani ndriçonte si një perde me rruaza. Kejti dredhoi në rrugicën nga e majta, duke shkuar pranë statujës gjigante të Hans Kristian Andersenit (Hans Christian Andersen). Tajrëlli dhe

Billi, të njëjtët burra, të pastrehë (se sa të pastrehë ishin ata, ajo e dinte më mirë nga kushdo, ata jetonin në San Remo dhe iu pëlqente të visheshin kështu), të cilët të ulur këtu çdo mëngjes, ishin, si gjithmonë, duke luajtur një lloj pokeri, *gin rummy*.

- Nga prapanicat dukesh mirë, vajzë, - tha Tajrëlli.

- Edhe ti, gjithashtu, - iu përgjigj Kejti.

Tajrëlli vdiste për këtë. Ai u ngrit në këmbë, i përdrodhi pak bythët, ia futi Billit me shuplakë dhe i hodhi letrat e tij në rrugicën ku ecte ajo. Billi e qortoi.

- Ngriji ato! - bërtiti Billi.

- Qetësohu, dakord?

- Kurs sot që në mëngjes? - iu drejtua Kejtit.

- Po.

- Sa veta?

- Tetë. Akoma s'ka kaluar Stejsi?

Sapo u përmend emri i saj, të dy burrat i hoqën kapelat dhe i vunë mbi zemrat e tyre me respekt. Billi pëshpëriti:

- Zot, ki mëshirë.

Kejti rrudhi vetullat.

Tajrëlli tha:

- Akoma jo.

Ajo vazhdoi djathtas dhe u rrotullua për qark pellgut *Conservatory Water*. Disa lloje varkash po bënë gara. Mbrapa hangarit të varkave Kerbs, ajo gjeti Akuan të ulur këmbëkryq. Sytë e tij ishin të mbyllur. Akuas, produkt i një babai afro-amerikan dhe një mamaje hebre, i pëlqente ta përshkruante lëkurën e tij si kafe moka me qumësht, me shllak sipër. Ai ishte i imët

dhe i zhdërvjellët dhe, pikërisht tani, i ulur në qetësi të plotë, kaq shumë i kundërt me djaloshin maniak me të cilin ajo ishte miqësuar shumë vite më parë.

- Je me vonesë, - tha Akua pa i hapur sytë.

- Si e bën këtë gjë?

- Çfarë? Të të shikoj ty me sy mbyllur?

- Po.

- Është një sekret i veçantë i mjeshtërve të jogës, - tha Akua, - quhet përgjim. Ulu.

Ajo u ul. Një minutë më vonë, Stejsi u bashkua me grupin. Akua nuk i bëri asaj asnjë qortim. Më parë kursi zhvillohej në *Great Lawn*... para, domethënë, se të zbarkonte Stejsi dhe të fillonte të demonstronte zhdërvjelltësinë e saj publikisht. Papritmas, burrat u bënë jashtëzakonisht të interesuar për jogën në mjedis të hapur. Akua nuk e pëlqente këtë, prandaj e bënte kursin e mëngjesit vetëm me femra dhe tani po i mbante femrat në këtë vend të fshehtë mbrapa hangarit të varkave. Vendi “i rezervuar” i Stejsit ishte ngjitur me murin, me qëllim që ata që donin të gjuanin me vështirësi nga larg, e kishin të zënë rrezen e shikimit.

Akua i drejtoi ato në një seri *pozicionesh qëndrimi në joga*. Çdo mëngjes, me shi, të kthjellët ose me dëborë, Akua drejtonte kursin e tij në këtë lloj vendi. Ai nuk i ngarkonte me ndonjë tarifë të veçantë. Ti i jepje çfarëdo që mendoje se ishte e përshtatshme. Ai ishte një mësues i mrekullueshëm, udhëzues, i këndshëm, motivues, i singertë, gazmor. Arrinte ta rregullonte pozicionin e qëndrimit *Downward Dog* ose *Warrior Two* me prekje të lehtë, pa lëvizur asgjë brenda teje.

Shumicën e ditëve, Kejti përhumbej pas pozicioneve të qëndrimit. Trupi i saj punonte shumë. Frymëmarrja e saj ngadalësohej. Mendja e saj dorëzohej. Në jetën e përditshme, Kejti pinte alkool, me raste edhe cigare dhe nuk hante rregullisht. Puna e saj mund të ishte një goditje e pastër, e pandërprerë toksinash. Por këtu, me zërin qetësues të Akuas, të gjitha ato davariteshin përgjithësisht.

Jo sot.

Ajo u përpoq ta largonte nga mendja, u përpoq të përqendrohej dhe të gjitha gjërat i dukeshin pa kuptim, madje dhe ato që thoshte Akua, por fytyra e Xhefit, ajo fytyrë që kishte njohur dhe ajo që sapo kishte parë nuk po i shqiteshin nga mendja. Akua e pa përhumbej e saj. Ia hodhi sytë me vëmendje dhe kaloi pak më shumë kohë për të rregulluar pozicionet e saja të qëndrimit dhe nuk i tha asgjë.

Në fund të çdo kursi, kur kursantët rrinin në pozicionin *Corpse*, Akua të vinte plotësisht nën magjinë e fjalëve të tij relaksuese. Çdo pjesë e jotja dorëzohej. Ti do të lëvizje. Ai pastaj do të të kërkonte të kaloje një ditë të bekuar, të veçantë. Ti do të shtriheshe atje edhe disa momente të tjera, duke marrë frymë thellë, me mollëzat e gishtave që të shponin. Me ngadalë, sytë e tu do të hapeshin duke u kapsallitur, ashtu siç po bënte Kejti tani, dhe Akua do të kishte ikur.

Kejti me ngadalë u rikthye në jetë. Të njëjtën gjë bënë edhe kursantet e tjera. Ato mblodhën me qetësi shtrojat e tyre, pothuajse të paaftha për të folur. Stejsi u

bashkua me të. Ato ecën për disa minuta duke kaluar *Conservatory Water*-in.

- E mban mend atë djalin me të cilin takohesha? - pyeti Stejsi.

- Patrikun?

- Po, atë.

- Ai m'u duk vërtet i ëmbël, - tha Kejt.

- Po, pra, më duhet ta heq qafe. Pasi zbulova se ai ka bërë diçka shumë të keqe.

- Çfarë?

- Bën biçikletë në palestër, - tha Stejsi.

Kejti ngriti sytë drejt qiellit.

- Jo, por imagjino, Kejt. Djali bën biçikletë në palestër. Po pastaj, ushtrimet e Kegelit?

Ishte e këndshme të ecje me Stejsin. Pas njëfarë kohe, nuk i vije re nguljet e syve dhe fishkëllimat. Nuk ishte e fyer dhe as nuk i shpërfillje ato. Ato thjesht nuk ekzistonin më. Të ecje në krah të Stejsit ishte gjëja më e përshtatshme që kishte mësuar ndonjëherë Kejt për t'u maskuar.

- Kejt?

- Po?

- Do të më thuash se ç'është e gabuar?

Një djalë trupmadh, me muskuj të palestruar, nga ai lloji ku i dallohen damarët dhe me flokë të lëpirë pas kokës, ndaloi përpara Stejsit dhe i hodhi sytë mbi gjoksin e saj.

- Uau, çfarë ballkoni paska kjo!

Stejsi gjithashtu ndaloi dhe i hodhi sytë mes kofshëve të tij.

- Uau, ai po që është kar i vogël.

Ato filluan të ecin përsëri. Në varësi të mënyrës së përqasjes, Stejsi e trajtonte vëmendjen në forma të ndryshme. Ajo e urrente kapadaillëkun që bie në sy, fishkëllimat *ngacmuese*, ato të pasjellshmet. Djemtë e druajtur, ata që thjesht admironin dhe pëlqenin atë që shikonin, këta po, Stejsi i pëlqente gjithashtu. Ndonjëherë, ajo do t'u buzëqeshte ose madje edhe do t'u tundej, pothuajse si një njeri i famshëm, i cili jepte diçka nga vetja, sepse ajo ishte një gjë e vogël dhe i bënte të tjerët të lumtur.

- Dje në mbrëmje hyra në atë faqen e internetit, - tha Kejti.

Kjo e bëri Stejsin të qeshë.

- Vërtet?

- Po.

- Uau. Ajo nuk do shumë kohë. U lidhe me ndonjë?

- Jo tamam.

- Çfarë ka ndodhur?

- Pashë ish-të fejuarin tim.

Stejsi u zgjat me sytë e hapur fort.

- Ma thuaj përsëri?

- Ai quhet Xhef Rejni.

- Prit pak, ke qenë e fejuar?

- Shumë kohë përpara.

- Por, e fejuar? Ti? Me unazë dhe me të gjitha gjërat e tjera?

- Pse çuditësh kaq shumë?!

- S'e di. Dua të them, sa kohë ka që jemi shoqe?

- Dhjetë vjet.

- E saktë, dhe gjatë gjithë kësaj kohe, ti asnjëherë nuk ke qenë brenda kufirit nuhatës të dashurisë.

Kejti mblodhi supet përgjysmë.

- Kam qenë njëzet e dy vjeçe.

- Më ke lënë pa fjalë, - tha Stejsi. - Ti. E fejuar.

- Mund ta kalojmë atë pjesë?

- Ke të drejtë, dakord, më fal. Dhe mbrëmë pe profilin e tij në atë faqen e internetit?

- Po.

- Çfarë i the ti?

- Kujt t'i them?

- Atij, - tha Stejsi.

- Çfarë?

- T'i them *atij*, jo *kujt t'i them*.

- Do të doja të kisha armën me vete, - tha Kejti.

- Eh, çfarë i shkrove, Xhefit?

- Nuk e bëra.

- Më fal?

- Nuk i shkrova.

- E pse jo?

- Ai më la.

- Një i fejuar, - Stejsi e tundi kokën përsëri. - Dhe ti nuk më ke folur kurrë për të më përpara? Më duket sikur e kam ngrënë.

- Çfarë është kjo?

- Nuk e di. Dua të them, kur bëhet fjalë për dashurinë, unë gjithnjë mendoj se ti je cinike, si unë.

Kejti vazhdonte të ecte:

- Si mendon ti se jam bërë cinike?

- Të lumtë, e gjete!

Ato gjetën një tryezë në restorantin *Le Pain Quotidien*, brenda në *Central Park*, pranë *Rrugës 69* në perëndim dhe porositën kafë.

- Më vjen me të vërtetë keq, - tha Stejsi.

Kejti ia bëri me dorë.

- Unë të regjistrova në atë faqe që ti të lidheshe. Zoti e di nëse ti do që të lidhesh. Dua të them, ti ke nevojë të lidhesh më pak nga kushdo tjetër që njoh unë.

- Kjo është njëfarë apologjie, - tha Kejti.

- Nuk doja të të sjell në mendje kujtime të këqija.

- Nuk është ndonjë gjë e madhe.

Stejsit nuk iu mbush mendja.

- Do që të flasim për atë? Sigurisht që do. Dhe unë jam kureshtare sa s'ka ku të shkojë më shumë. Më trego çdo gjë.

E kështu, Kejti ia tregoi asaj të gjithë historinë me Xhefin. I tregoi si u takuan në "Columbia", si ranë në dashuri, si iu duk asaj se dashuria do të zgjaste përgjithnjë, si i dukej e lehtë dhe e drejtë gjithçka, si i kishte propozuar Xhefi, si ndryshoi çdo gjë kur u vra babai i saj, si ajo u bë më e tërhequr, si iku Xhefi përfundimisht, si ishte bërë ajo shumë e dobët ose shumë krenare, për t'i shkuar atij nga mbrapa.

Kur Kejti mbaroi, Stejsi tha:

- Uau.

Kejti gjerbi pak kafë.

- Dhe tani, pothuajse njëzet vjet më vonë, ti e shikon të fejuarin tënd në një faqe interneti për takime?

- Po.

- Beqar?

Kejti rrudhi vetullat.

- Ka shumë pak njerëz të martuar në atë faqe.

- Po, sigurisht. Atëherë, si është puna? Është i divorcuar? Ka ndenjur gjithë ditën në shtëpi, duke u përvëlur, si puna jote?

- Unë nuk po përvëlohem më, - tha Kejti e, më pas, vazhdoi: - Ai është i ve.

- Uau.

- Mos e thuaj më këtë “uau”. Çfarë je ti, vajzë shtatë vjeçe?

Stejsi e shpërfilli minishpërthimin e saj.

- Quhet Xhef, apo jo?

- Po.

- Po kur Xhefi e prishi muhabetin, e doje më?

Kejti u gëlltit.

- Po, sigurisht.

- Mendon se ai vazhdon të të dojë?

- Me sa duket jo.

- Mjaft me këtë. Mendo për pyetjen. Harroje për një sekondë që ai të ka lënë.

- Poo, por është pak e vështirë për t'u harruar. Unë jam një vajzë, që “veprimet i flasin më shumë sesa fjalët”.

Stejsi u përkul më afër.

- Të them të drejtën ka pak njerëz, të cilët e shikojnë anën tjetër të dashurisë dhe të martesës më qartë sesa ti. Ne që të dyja e dimë këtë, apo jo?

- Po.

- Ti mëson shumë për marrëdhëniet, ndërsa puna jote, në njëfarë mënyre, pothuajse i shkatërron ato.

Por, e vërteta është se pothuajse çdo marrëdhënie ka momente të vështira. Çdo marrëdhënie ka plasaritje dhe të çara. Kjo nuk do të thotë që ajo është pa kuptim apo e keqe, ose qoftë edhe e gabuar. Ne e dimë që çdo gjë në jetët tona është e ndërlikuar dhe gri. Megjithatë, ne presim në njëfarë mënyre që marrëdhënia jonë të mos jetë asgjë më shumë sesa e thjeshtë dhe e pastër.

- Shumë e vërtetë, - tha Kejti, - por nuk po kuptoj se ku po e hedh fjalën.

Stejsi u përkul më afër.

- Kur u ndave ti me Xhefin, të donte ai? Mos më thuaj gjëra të tipit “veprimet flasin më shumë sesa fjalët”. Të donte ende ai ty?

Dhe pastaj, pa menduar shumë për të, Kejti tha:

- Po.

Stejsi u ul aty, duke ia ngulur sytë shoqes së saj.

- Kejt?

- Çfarë?

- Ti e di njëqind herë që unë nuk jam besimtare, - tha Stejsi, - por kjo duket një çikë si, nuk e di, fat apo ndonjë gjë e tillë.

Kejti piu një gllënjë tjetër me kafë.

- Ti dhe Xhefi jeni që të dy beqarë. Jeni që të dy të lirë. Keni qenë pothuajse duke vënë unazat.

- Është prishur, - tha Kejti.

Stejsi e mendoj këtë.

- Jo, nuk është ajo që unë... Dakord, po, një pjesë e saj, sigurisht. Por jo edhe aq e prishur sa... realiste.

Stejsi qeshi dhe hodhi vështtrimin larg.

- Oh! Shoku.

- Çfarë?

Stejsi ndeshi në vështrimin e saj, buzëqeshja ishte ende aty.

- Kjo mund të jetë një përrallë. E kupton?

Kejti nuk tha asgjë.

- Madje akoma më mirë. Ti dhe Xhefi ishit mirë më përpara, apo jo?

Kejti përsëri nuk tha gjë.

- Nuk e shikon? Këtë herë, ju mund të filloni përsëri, por me sytë më të hapur. Mund të jetë një përrallë, por e vërtetë. Ti i shikon plasaritjet dhe të çarat. Tashmë ti mund ta fillosh me një ngarkesë emocionale tjetër dhe me një përvojë e pritshmëri të ndershme. Një vlerësim për atë rrëmujën që keni bërë bashkë shumë kohë përpara. Kejt, dëgjomë mua, - Stejsi zgjati dorën e saj mbi tavolinë dhe kapi të Kejtit. Në sytë e saj kishte lot, - kështu mund të jetë me të vërtetë, me të vërtetë shumë mirë.

Kejti vazhdonte të mos përgjigjej. Ajo nuk i besonte zërit të vet, madje, nuk po e linte veten që të mendonte për atë gjë. Por ajo e dinte. E dinte me saktësi çfarë donte të thoshte Stejsi.

- Kejt?

- Kur të kthehem në apartament do t'i dërgoj një mesazh Xhefit.

4

PASI doli nga dushi, Kejti po mendonte se çfarë të shkruante saktësisht në mesazhin e saj për Xhefin. Po endej nëpër një mori mundësish, njëra më e dobët sesa tjetra. E urrente këtë ndjesi. Urrente të shqetësohej se çfarë do t'i shkruante një djali, sikur të ishte në shkollën e mesme dhe të linte një shënim në *draftin* e tij. Uf! Ende nuk jemi rritur për gjëra të tilla?

“Një përrallë, - kishte thënë Stejsi. - Por e vërtetë.”

Ajo veshi uniformën e saj të punës, një palë xhinse, një xhakëtë sportive dhe një palë këpucë TOMS. Flokët i mblodhi bishtkali mbrapa. Kejti nuk kishte pasur kurrë kurajën që t'i priste flokët shkurt, por gjithmonë kishte pëlqyer t'i mblidhte mbrapa, pa ia zënë fytyrën. Xhefi e kishte pëlqyer gjithashtu këtë formë. Shumica e burrave i pëlqente flokët e saj të derdhur poshtë. Xhefi jo.

“E dashuroj fytyrën tënde. I dashuroj ato mollëza dhe ata sy...”

E mbajti veten.

Koha për të shkuar në punë. Do ta vriste mendjen më vonë se çfarë do të shkruante.

Monitori i kompjuterit dukej sikur po e tallte kur ajo ishte duke kaluar, duke e nxitur që të ikte. Ajo ndaloi. Fotografia në ekran bënte vallëzimin e saj të lehtë. Pa orën.

Mbaroje që tani këtë punë, i tha vetes.

Kejti u ul dhe hapi përsëri faqen *YouAreJustMyType.com*. Kur faqja u hap, pa se kishte “përputhje të reja emocionuese”. Nuk u mërzit për këtë. E gjeti profilin e Xhefit, klikoi në fotografinë e tij, lexoi edhe një herë prezantimin e tij personal.

Bëj atë që duhet të bësh.

Sa shumë kohë, pyeste veten, i ishte dashur Xhefit që të vinte me diçka kaq të thjeshtë, kaq tërheqëse, kaq relaksuese, kaq neutrale? Nuk kishte presion. Një ftesë, asgjë më shumë. Kejti klikoi mbi ikonë për t’i shkruar drejtpërdrejt një mesazh. Kutia e tekstit doli. Kursori pulsonte i paduruar.

Kejti shkroi: Po, bëj atë që duhet të bësh.

Uf!

E fshiu menjëherë.

Provoi edhe disa të tjera. Gjeje kush; Ka kaluar një kohë e gjatë; Si je, Xhef?; Është gjë e bukur që po shikoj përsëri fytyrën tënde. Fshije, fshije, fshije.

Çdo shprehje ishte e ngrirë në fuqinë infinit. Ndoshta, mendoi ajo, kjo ishte natyra e këtyre gjërave. Është e vështirë të jesh e butë, e sigurt apo e qetë, kur je në një faqe interneti, duke u përpjekur për të takuar dashurinë e jetës sate.

Një kujtim i solli një buzëqeshje të trishtuar në fytyrë. Xhefit i pëlqenin shumë videot e zakonshme muzikore të viteve tetëdhjetë. Kjo ishte përpara se *YouTube* ta bënte të thjeshtë që të shikoje çfarëdo dhe të gjitha pothuajse menjëherë. Duhej të gjeje se kur televizioni kabllor VH1 (*Video Hits One*) jepte ndonjë gjë të veçantë apo diçka të ngjashme. Papritur, po përfytyronte se çfarë ishte duke bërë tani Xhefi, ndoshta ishte ulur para kompjuterit dhe po shikonte video të vjetra nga grupet muzikore: *Tears for Fears*, *Spandau Ballet*, *Paul Young* ose *John Waite*.

Xhon Uejt.

Uejti kishte një këngë klasike të hershme të MTV-së, pothuajse një këngë e zhanrit *new-wave pop*, e cila gjithmonë e bënte të kërcente, madje edhe tani, qoftë sikur të ishte duke kërkuar nëpër stacionet e radios apo në ndonjë bar ku luhej muzika e viteve tetëdhjetë. Kejti do ta dëgjonte Xhon Uejtin duke kënduar: *Mall për ty*, kjo do ta kthente mbrapa në kohë tek ajo video vërtet sentimentale, Xhoni ecte i vetëm nëpër rrugë, duke thirrur vazhdimisht: *Nuk ndiej aspak mall*, dhe me një zë të mbushur me dëshpërim të madh dhe tejet shpjegues këndonte vargun tjetër: *Unë mund ta gënjej veten time*. Xhon Uejti do të ishte në një bar, duke u mbytur nga dhimbjet e tij të mëdha, duke u kthyer

me gëzim mbrapa në kujtimet e bukura të gruas që ai do të dashuronte përjetë, ndërkohë që të gjithë këndonin në kor se ai nuk ia ndiente fare mungesën. Oh, po, ne po dëgjojmë diçka të gënjeshtërt. Ne po e shohim gënjeshtrenë në çdo hap, në çdo lëvizje. Pastaj, në fund të videos, Xhoni i vetmuar shkon në shtëpi dhe vë kufjet, duke e mbytur tani dhimbjen më shumë me muzikë sesa me pije dhe kështu, në një tragjedi të ngjashme me diçka shekspiriane në një situatë komike, ai nuk mund ta dëgjojë të dashurën e tij që troket në derë. Në fund, dashuria e madhe me të cilën ai kishte menduar të jetonte përgjithnjë, troket përsëri, e vë veshin në derë dhe pastaj largohet, duke e lënë Xhon Uejtin me zemër të thyer përgjithmonë, duke u munduar ta bindte veten se nuk ndiente mall për të.

Ironike në prapamendim.

Kjo video u bë në njëfarë mënyre një shaka e vazhdueshme midis saj dhe Xhefit. Kur ata ishin larg, qoftë edhe për një kohë të shkurtër, ai do t'i linte një mesazh që thoshte: *Nuk ndiej fare mall për ty*, dhe ajo që do ta komentonte se ai e thoshte këtë për të gënjyer veten.

Eh, po, romanca nuk është gjithmonë e bukur.

Por, kur Xhefi donte të bëhej më shumë serioz, ai do t'i nënshkruante shënimet e veta me titullin e kësaj kënge, titull të cilin në këtë moment gishtat e saj ishin duke e shtypur pothuajse në mënyrë të pandërgjegjshme në kutinë e tekstit:

MALL PËR TY.

Ajo e pa për një moment dhe po mendohej të shtypte *SEND*.

Kjo ishte më shumë sesa vrasëse. Si përgjigje ndaj shprehjes së rafinuar *Bëj atë që duhet të bësh* ajo po kundërvinte *Mall për ty*. Jo. Ajo e fshiu dhe u përpoq edhe një herë, duke përmendur vargun aktual nga kori:

Nuk ndiej fare mall për ty.

Kjo dukej shumë ngacmuese. Edhe një e fshirë tjetër.

Dakord, mjaft më.

Atëherë i erdhi një ide. Kejti hapi një dritare tjetër kërkimi dhe gjeti një link të videos së vjetër të Xhon Uejtit. Nuk e kishte parë atë video ndoshta prej njëzet vjetësh, por ajo e ruante ende gjithë freskinë e sharmit të saj. Po, mendoi Kejti duke tundur kokën, e përsosur. Kopjoi linkun dhe e kaloi në fushën e tekstit. U shfaq një fotografi nga skena në bar e videos. Kejti nuk mendoi më gjatë.

E shtypi butonin *SEND*, u ngrit shpejt dhe pothuajse vrapoi jashtë derës.

* * *

KEJTI jetonte në *Rrugën 67*, në pjesën e sipërme perëndimore. Vendi i saj i punës, në zonën Nr. 19 *Precinct*, ishte gjithashtu në *Rrugën 67*, ndonëse në pjesën lindore, jo shumë larg nga kolegji “Hunte”.

Ajo kujdesej për vajtje-ardhjen e saj duke ecur drejt përmes *Central Parkut*. Grupi i saj ishte vendosur në një ndërtesë historike të viteve 1880, me një stil që dikush kishte thënë se quhej *Ringjallja e Rilindjes*. Punonte si detektive në katin e tretë. Në televizor, detektivët zakonisht kishin disa lloje specialitetesh, si vrasja, por shumica e këtyre nënspecialiteteve ose titujve kishte kohë që kishin ikur. Vitin që u vra babai i saj, pati afërsisht katërqind vrasje. Këtë vit, deri tani, kishin pasur dymbëdhjetë. Grupet detektive, me nga gjashtë veta, për vrasjet dhe të ngjashme me to, ishin bërë të panevojshme.

Menjëherë sapo ajo kaloi sportelin e hyrjes, Ket Inçierka, rreshteri që ishte në detyrë, tha:

- Kapiteni të kërkon tani, - Ket i tregoi me gishtin e madh të tultë, sikur Kejti të mos e dinte se ku ishte zyra e kapitenit. I ngjiti shkallët dy e nga dy për të shkuar në katin e dytë. Pavarësisht nga lidhja e saj personale me kapiten Stagerin, ajo rrallëherë thirrej në zyrën e tij.

Ajo trokiti lehtë në derën e tij.

- Hyr.

Ajo hapi derën. Zyra e tij ishte e vogël dhe me dysHEME gri, si e lagur nga shiu. Ai ishte përkulur mbi tavolinë me kokën e ulur. Goja e Kejtit menjëherë u bë e thatë. Koka e Stagerit kishte qenë e ulur edhe atë ditë, tetëmbëdhjetë vjet më parë, kur ai kishte trokitur në derën e apartamentit të saj. Kejti nuk e kishte kuptuar. Jo që në fillim. Ajo gjithmonë mendonte se duhej ta dinte se ajo trokitje në derë, do të ishte ndonjë paralajmërim apo diçka e ngjashme. E kishte

përftytyruar skenën me qindra herë në kokën e vet. Natën vonë, shiu binte rrëke, një trokitje në derë. Ajo do ta hapte derën, duke e ditur se çfarë do të ndodhte. Vështrimi i saj do të kryqëzohej me atë të një polici, ai do ta tundte lehtë kokën, dhe pastaj ajo do të rrëzohej përtokë duke bërtitur:

- Jo!

Por, kur ndodhi trokitja me të vërtetë, kur Stageri kishte ardhur për të sjellë të rejtat që do ta çanin më dysh jetën e saj, një person përpara atij momenti, një tjetër më pas, dielli po shkëlqente pa asnjë pengesë. Ajo ishte nisur për në pjesën e sipërme të qytetit, në bibliotekën e kampusit në “Columbia”, që të punonte me një dokument për Planin Marshall. Ende e mbante mend këtë. Plani i mallkuar Marshall. Kështu, ajo hapi derën, gati për të dalë të merrte trenin C dhe ndeshi me Stagerin, i cili qëndronte me kokën ulur, tamam si tani dhe ajo nuk e njihte. Ai nuk e pa në sy. E vërteta, e vërteta e çuditshme, e turpshme, ishte që kur e pa Stagerin për herë të parë në korridor, Kejti mendoi se ndoshta ai kishte ardhur për të. Kishte dyshuar se Stageri e pëlqente atë. Policët e rinj, por veçanërisht ata që e konsideronin të atin si model, çmendeshin pas saj. Prandaj, kur Stageri u duk në fillim në prapun e derës së saj, kjo ishte gjëja që kishte menduar dhe pavarësisht se e dinte që ajo ishte e fejuar me Xhefin, Stageri bëri një lëvizje të lehtë drejt saj. Pa presion. Stageri, emri i të cilit ishte Tomas, emër që asnjëherë dhe askush nuk e kishte përdorur, nuk ishte si tipi i Xhefit. Por diçka e ëmbël.

Kur pa gjakun në këmishën e tij, sytë iu zvogëluan, por të vërtetën nuk e kishte marrë vesh ende. Pastaj ai tha tri fjalë, tri fjalë të thjeshta, të cilat dolën bashkë dhe shpërthyen në gjoksin e saj, duke e shfryrë larg botën e saj.

- Lajm i keq, Kejt.

Stageri tani po i afrohej të pesëdhjetave, i martuar, me katër djem. Tavolinën e kishte të mbushur nga fotografitë. Ishte një fotografi e vjetër e Stagerit me partnerin e tij të fundit, detektivin e brigadës kriminale, Henri Donovan, alias Baba. Kështu ishte. Kur vdisje në punë, fotografia jote përfundonte gjithandej. Përkujtim i bukur për dikë. Kujtim i dhimbshëm për të tjerët. Në murin prapa Stagerit, ishte një poster ku dukej djali i madh i Stagerit, një rinok në shkollën e mesme, duke luajtur *lacrosse*. Stageri dhe gruaja e tij banonin në Bruklin. Kishin një jetë të këndshme, mendonte ajo.

- Doje të më takoje, kapiten?

Jashtë zonës së policisë, ajo e thërriste atë Stager, por kur ishte fjala për çështjet profesionale, ajo nuk mund ta bënte këtë. Kur Stageri ngriti kokën, ajo u habit kur e pa të zbehtë në fytyrë. Në mënyrë të pavullnetshme u prapsua, pothuajse duke pritur të dëgjonte përsëri ato tri fjalë, por këtë herë e pyeti ajo.

- Ç'ka ndodhur?

- Monte Leburni, - tha Stageri.

Ai emër e thithi gjithë ajrin e dhomës. Pas një jete të pavlerë, me asgjë tjetër përveç shkatërrimit, Monte Leburni po vuante burgimin e përjetshëm për vrasjen

e detektivit të Departamentit të Vrasjeve të Policisë së Nju-Jorkut, Henri Donovanit.

- Ç’lidhje ka ai?

- Ai po vdes.

Kejti ia bëri me kokë, duke u përpjekur të rimarrë veten nga turbullimi.

- Nga se?

- Kancer në pankreas.

- Sa kohë ka që është sëmurë?

- Nuk e di.

- Pse po ma thua pikërisht tani?

Zëri i saj ishte më i mprehtë nga sa ia kishte marrë mendja asaj. Ai i ngriti sytë për ta parë. Ajo i bëri me shenjë që e kishte falur.

- Sapo e mësova edhe unë, - tha ai.

- Kam shkuar disa herë për ta takuar.

- Po, e di.

- Ai nuk ishte kundër. Por kohët e fundit...

- E di edhe këtë, - tha Stageri.

Qetësi.

- Është ende lart në “Klinton”? - pyeti ajo.

“Klintoni” ishte një qendër korrektimi e sigurisë së lartë në pjesën e sipërme të shtetit të Nju-Jorkut, afër kufirit me Kanadanë, me sa thuhej vendi më i vetmuar, më i ftohtë në tokë. Ai ishte gjashtë orë me makinë nga qyteti i Nju-Jorkut. Kejti e kishte bërë atë udhëtim të mërzitshëm shumë shpesh.

- Jo. E kanë lëvizur në “Fishkill”.

Mirë. Tani ishte shumë më afër. Ajo mund të shkonte aty brenda nëntëdhjetë minutave.

- Sa kohë ka aty?

- S'ka shumë.

Stageri filloi të vijë rrotull tavolinës, ndoshta për t'i dhënë një përqafim ose për ta ngushëlluar, por u tërhoq shpejt.

- Kjo është gjë e mirë, Kejt. Ai e meriton të vdesë. Ai meriton edhe më keq.

Ajo tundi kokën.

- Jo.

- Kejt...

- Kam nevojë të flas përsëri me të.

Ai tundi kokën ngadalë.

- E mendova se do ta thoshe këtë.

- Dhe?

- Kam bërë një kërkesë. Leburni refuzon të të takojë.

- Shumë keq, - tha ajo. - Unë jam police. Ai është një i dënuar për vrasje në prag të vdekjes me një sekret të madh.

- Kejt.

- Çfarë?

- Edhe sikur të mund ta bësh atë të flasë tani, dhe ne e dimë që kjo nuk do të ndodhë, ai nuk do të jetojë derisa të dalë në gjyq, gjithsesi.

- Ne mund t'i vëmë atij një regjistruer. Rrëfim në shtratin e vdekjes.

Stageri dukej skeptik.

- Duhet të përpiqem.

- Ai nuk do të të takojë.

- Mund të marr borxh një makinë nga rezervat?

Ai i mbylli sytë pa thënë asnjë fjalë.

- Të lutem, Stager?!

Ishte shumë për ta thirrur atë kapiten.

- Partneri yt do ta bëjë edhe punën tënde?

- Patjetër, - gënjeu ajo. - Sigurisht.

- Gjithsesi, nuk më duket se kam ndonjë mundësi tjetër për të zgjedhur, - tha ai me një psherëtimë dorëzimi.

- Në rregull, shko.

5

GERARD Remingtoni më në fund e pa dritën e diellit.

Ai nuk e kishte idenë se sa gjatë kishte qenë në errësirë. Vërshimi i papritur i dritës shpërtheu në sytë e tij si një shpërthim yjor. Sytë e tij u mbyllën. Ai donte edhe t'i mbronte, por i kishte duart ende të lidhura. U përpoq t'i kapsalliste, sytë e tij u përлотën nga drita e fortë. Dikush qëndronte drejtpërdrejt mbi të.

- Mos lëviz, - tha një zë burri.

Gerardi nuk lëvizi. Ai dëgjoi një zhurmë kërcitëse dhe kuptoi që burri ishte duke prerë lidhëset. Për një moment të shkurtër, shpresa ia mbushi gjoksin. Ndoshta, mendoi Gerardi, ky njeri ka ardhur për të më shpëtuar.

- Ngrihu, - tha burri tani. Ai kishte një theks karakteristik, ndoshta si dikush nga Karaibet apo nga

Amerika e Jugut. - Unë kam një armë. Në qoftë se bën ndonjë lëvizje, ne të vrasim dhe të groposim këtu. E kupton?

Goja e Gerardit ishte shumë e tharë, por përsëri, ai mundi të thotë:

- Po.

Burri doli jashtë... kutisë? Për herë të parë, Gerard Remingtoni mundi të shohë se ku e kishin mbajtur gjithë këto... orë. Ishte diçka me përmasa midis një qivuri dhe një dhome të vogël, ndoshta katër këmbë (*afërsisht 120 cm*) e thellë dhe e gjerë, dhe ndoshta tetë këmbë e gjatë. Kur u ngrit, Gerardi pa se ishte në mes të një pylli të thellë. Dhoma ishte e gërmuar nën tokë. Në njëfarë mënyre një bunker i fshehur. Ndoshta diçka për t'u fshehur gjatë ndonjë stuhie apo ndonjë gjë për të mbajtur drithin. Ishte e vështirë të thuhej.

- Dil jashtë, - tha burri.

Gerardi picërroi sytë. Burrë, jo, në fakt ai ishte pothuajse adoleshent, trupmadh dhe muskolor. Theksi i tij tani dukej sikur kishte diçka portugeze, ndoshta braziliane, por Gerardi nuk ishte ekspert. Flokët i kishte të shkurtër, kaçurrelë, të dendur. Kishte veshur xhinse të grisura dhe një bluzë *t-shirt* pas trupit, e cila i rrinte pothuajse si një fasho për ndalimin e gjakut në muskujt e fryrë të krahëve të tij.

Kishte edhe një armë.

Gerardi doli jashtë kutisë për te drurët. Në largësi, pa një qen, dukej si Labrador ngjyrë çokollatë që po vraponte në një rrugicë. Kur burri e mbylli kapakun e bunkerit, bunkerit u zhduk nga sytë. Mund të shihje

vetëm dy unaza të mëdha metali, një zinxhir dhe një dry e të gjitha mbi derë.

Gerardit po i vinte mendja rrotull.

- Ku jam?

- Ti qelbesh, - tha burri i ri. - Atje është një zorrë uji, mbrapa asaj pemës. Lahu, mbaro punët e tua dhe vishe këtë.

I riu i dha Gerardit një palë kominoshe me ngjyra kamuflazhi.

- Nuk po kuptoj asgjë, - tha Gerardi.

Burri muskolor dhe i armatosur lëvizi menjëherë pranë tij. Filloi të lëvizë muskujt e krahavorit dhe të krahëve.

- Mos do që të të jap ca shkelma bythëve?

- Jo.

- Atëherë bëj si të them unë.

Gerardi u përpoq të gëlltitej, por përsëri fyti i tij ishte shumë i tharë. U kthye në drejtim të zorrës së ujit. Harroi larjen. Kishte nevojë për ujë. Gerardi filloi të vrapojë në drejtim të zorrës së ujit, por gjunjët e tij u përthyen, pothuajse duke e përplasur përdhe. Kishte ndenjur shumë gjatë në atë kuti. Më në fund, arriti të qëndrojë në këmbë aq gjatë sa të shkojë te zorra e ujit. Hapi rubinetin. Kur doli uji, piu i babëzitur. Uji kishte një shije... si të ndenjur nëpër tuba, por ai nuk donte t'ia dinte.

Gerardi priti që burri t'i bërtasë përsëri, por papritur u bë i duruar. Kjo e ngacmoi Gerardin për disa arsye. Ai pa përqark. Ku ishte? U kthye në formë rrethi. U rrotullua duke shpresuar të gjente ndonjë hapësirë apo

një rrugë ose diçka të ngjashme. Por atje nuk kishte asgjë. Vetëm drurë.

U përpoq të dëgjonte ndonjë zhurmë. Përsëri asgjë.

Ku ishte Vanesa? Mos po priste ende për të në aeroport, e çorientuar, por e sigurt?

Apo e kishin rrëmbyer edhe atë?

Gerard Remingtoni shkoi mbrapa pemës dhe hoqi rrobat e tij gjithë dhé. Burri nuk ia ndante sytë. Gerardi po mendohej kur kishte qenë herën e fundit lakuriq përpara një burri. Mendoi se kishte qenë në orën e edukimit fizik, në shkollën e mesme. Ishte e çuditshme të mendoje për këtë gjë në një moment të tillë.

Ku ishte Vanesa? A ishte mirë ajo?

Ai nuk e dinte, sigurisht. Nuk dinte asnjë gjë. Nuk e dinte se ku ishte apo kush ishte ky njeri ose pse ishte ai këtu. Gerardi u përpoq ta merrte shtruar, u përpoq të mendonte në mënyrë racionale për lëvizjen e vet të radhës. Ai duhet të bashkëpunonte dhe të përpiquej sa më shumë që të mundte për të mbajtur mendjen në formë. Gerardi ishte i zgjuar. Ai ia kujtoi vetes këtë gjë pikërisht tani. Pastaj po, vërtet u ndje më mirë.

Ai ishte i zgjuar. Kishte një grua që e dashuronte, një punë fantastike dhe një të ardhme të mrekullueshme përpara. Ky kafsha kishte një armë, po, por ajo nuk krahasohej me intelektin e Gerard Remingtonit.

Burri më në fund foli:

- Nxito.

Gerardi mbaroi me tubin e ujit.

- Ke një peshqir? - pyeti ai.

- Jo.

Ende i lagur, Gerardi rrëshqiti brenda kominosheve. Atij i kishin filluar të ngjethura. Ndërthurja e frikës, lodhjes, konfuzionit dhe humbjes e kishin bërë të vetën.

- E shikon atë monopatin?

Burri me muskujt e fryrë bëri me shenjë në drejtim të së njëjtës hapësirë ku Gerardi kishte parë qenin të vraponte.

- Po.

- Ndiqe deri në fund. Në qoftë se hedh një hap jashtë tij, do të të qëlloj.

Gerardi nuk e zgjati që të diskutonte urdhrin. Ai filloi të ecë tatëpjetë monopazit të ngushtë. Të largohej me vrap nuk i dukej se ishte e mundur. Edhe në qoftë se burri nuk e qëllonte, ku mund të shkonte ai? Ndoshta mund të fshihej nëpër drurë. Shpresonte t'ia kalonte atij. Por nuk e kishte idenë se cilin drejtim duhej të merrte. Nuk e kishte idenë nëse do të ishte duke vrapuar drejt ndonjë rruge apo më thellë nëpër natyrën e egër.

Ai ishte, si dukej, një plan i çmendur.

Tjetër, edhe nëse këta njerëz donin që ta vrisnin, ai e kishte marrë me mend se ishin më shumë se një, që kur kafsha tha “ne”, ata do ta kishin bërë deri tani. Prandaj bëhu i zgjuar. Ji i vëmendshëm. Rri gjallë.

Gjej Vanesën.

Gerardi e dinte se hapi i tij ishte afërsisht 81 cm, po numëronte hapat. Kur arriti në dyqind hapa, të cilët shkonin deri në 162 metra, vuri re se monopati ndërpritej.

Jo shumë larg ishte një hapësirë. Dymbëdhjetë hapa më tutje dhe Gerardi ishte jashtë drurëve të dendur. Përpara tij ishte një shtëpi fshati e bardhë. Gerardi e studioi atë nga larg, vuri re se dritaret e katit të sipërm kishin grila ngjyrë jeshile të errët. Ai po kërkonte telat elektrikë që shkonin drejt shtëpisë. Nuk kishte asnjë.

Interesante.

Një njeri po rrinte në hyrjen e shtëpisë. Ai ishte mbështetur pa e vrarë mendjen në një nga shtyllat e verandës. Mëngët i kishte të përveshura, krahët të kryqëzuar. Kishte vënë syze dielli dhe çizme pune. Flokët i kishte biondë, të palarë dhe të gjatë gjer mbi shpatulla. Kur e vuri re Gerardin, ia bëri me shenjë që të hynte brenda. Pastaj njeriu rrëshqiti brenda dhe u zhduk nga pamja.

Gerardi u nis në drejtim të shtëpisë. Përsëri i vuri re nuancat gri. Në të djathtën e tij ishte një hangar, përpara të cilit rrinte një Labrador në ngjyrë çokollatë që shihte me durim. Prapa qenit, Gerardi mundi të shikojë qoshen e diçkaje, që dukej si një kaloshin gri për kalë. Hëm. Gerardi pa edhe një mulli me erë. Këto ishin të dhënat. Kjo kishte kuptim. Ai nuk e dinte çfarë kishin ndër mend ata, ose ndoshta e dinte dhe kjo e bënte situatën akoma më konfuze, por për momentin vetëm sa i fiksoi të dhënat.

Eci dy hapa në verandë dhe hezitoi nga dera e hapur. Mori frymë thellë dhe hyri në hollin e përparmë. Dhoma e ndenjjes ishte në të majtë të tij. Burri me flokët e gjatë po rrinte në një karrige të

madhe. Tani i kishte hequr syzet e diellit. Sytë i kishte kafë, por të përsququr. Parakrahët i kishte të mbuluar me tatuazhe. Gerardi i studioi ato, duke u përpjekur të formojë në mendje një fotografi, me shpresë se do të gjente ndonjë shenjë për të kuptuar se kush mund të ishte ky njeri. Por tatuazhet ishin vizatime të thjeshta dhe nuk tregonin asgjë.

- Emri im është Titus. Në zërin e tij kishte një tingull gazmor. Diçka të argjendtë, të butë e pothuajse të brishtë. - Të lutem ulu.

Gerardi hyri në dhomë. Burri me emrin Titus e gozhdoi me sy. Gerardi u ul. Një burrë tjetër, që dikush mund ta quante një hipi, hyri në dhomë. Kishte veshur një bluzë plot ngjyra, një kapelë të thurur dhe një palë syze ngjyrë rozë. Ai u ul te tavolina në qoshe dhe hapi një laptop *MacBook Air*. Të gjithë laptopët *MacBook Air* dukeshin njësoj, sigurisht, gjë që e kishte bërë Gerardin të vinte një copë të vogël shiriti ngjites të zi sipër tij.

Shiriti i zi ishte ende aty.

Gerardi u vrenjt.

- Ç'po ndodh? Ku është Vanesa?

- Shëët, - tha Titusi.

Zëri u shpërnda nëpër ajër si kosa e një kositësi.

Titusi u kthye nga hipija me laptop. Hipija bëri me kokë nga ai dhe tha:

- Gati.

Gerardi pothuajse pyeti:

- Gati për çfarë? - por zëri i asaj shëët vazhdonte ta mbante atë pa folur.

Titusi u kthye nga Gerardi dhe qeshi. Ajo ishte pamja më e frikshme e mundshme që kishte parë ndonjëherë Gerard Remingtoni.

- Ne kemi disa pyetje për ty, Gerard.

6

QENDRA e korrektimit “Fishkill” kishte qenë, në origjinë, spitali shtetëror “Matteawan” për kriminelët psikopatë. Kështu ishte pas vitit 1890. Ai kishte mbetur, në një mënyrë apo në një tjetër, një spital shtetëror për të sëmurët mendorë deri në vitin 1970, kur gjykatat e bënë më të vështirë marrjen përsipër në mënyrë arbitrare të atyre që konsideroheshin të çmendur. Tani “Fishkilli” ishte emërtuar një burg i sigurisë së mesme, megjithëse aty kishte gjithçka, që nga të burgosurit me siguri minimale, që përfitonin leje për të punuar diku dhe deri tek ata të sigurisë maksimale në Bllokun S.

Me vendndodhje në Bekon, Nju-Jork, e ndërtuar në trajtë disi piktoreske ndërmjet lumit Hudson dhe kreshtave Fishkill, ndërtesa e hershme me tulla vazhdonte të dukej mikpritëse kur mbërrije aty. Me

telat me gjemba dhe i pamirëmbajtur, vendi dukej si një kamp studentor i Ligës Ivy të Aushvicit.

Kejti e përdorte mirësjelljen profesionale dhe distinktivin e saj të artë për të kapërcyer shumicën e pikave të sigurisë. Në Departamentin e Policisë së Nju-Jorkut, policët në rrugë kishin distinktivë të argjendtë. Detektivët i kishin të artë. Numri i distinktivit të saj, 8115, kishte qenë i babait të saj.

Një infermiere e moshuar, e veshur me të bardha dhe me një skufje të qëmotshme infermiereje, e ndaloi në krah të spitalit. Makijazhi i saj ishte tepër i ndezur, pluhur sysh blu të thellë, të kuq buzësh me ngjyrë të theksuar të kuqe; dukej sikur dikush kishte shkrië lapsa me ngjyrë në fytyrën e saj. Ajo buzëqeshi me shumë ëmbëlsi, me të kuqin e buzëve në dhëmbë.

- Zoti Leburni ka kërkuar të mos lejohen vizitorë.

Kejti e nxori përsëri distinktivin e saj.

- Unë dua vetëm sa ta shikoj, - ajo dalloj një etiketë me emër ku shkruhej "sylvia steiner, rn", - infermiere Steiner.

Infermierja Steineri e kapi distinktivin e artë, e lexoi me nge, pastaj ngriti sytë për të studiuar fytyrën e Kejtit. Kejti nuk e ndryshoi shprehjen e fytyrës.

- Nuk e kuptoj. Pse je këtu?!

- Ai ka vrarë babanë tim.

- E kuptoj. Dhe ti do që ta shohësh duke vuajtur?

Në zërin e infermieres Steineri nuk kishte paragjykim. Dukej sikur kjo duhet të ishte gjëja më e natyrshme në botë.

- Oh, jo! Kam ardhur për t'i bërë disa pyetje.

Infermierja Steineri i hodhi edhe një vështrim tjetër distinktivit dhe ia ktheu:

- Fillojmë këtej, e dashur.

Zëri i saj ishte melodik, engjëllor dhe ngjethës. Infermierja Steineri e çoi në një dhomë me katër krevate. Tre ishin bosh. Në të katërtin, në atë që ishte në qoshen djathtas, Monte Leburni ishte shtrirë me sytë e mbyllur. Në kohën e tij, Leburni kishte qenë një njeri trupmadh, i fortë e muskulator. Në qoftë se për një krim duhej dhunë fizike ose frikësim, Monte Leburni ishte ai i forti që e thërrisnin. Një ish-boksier i peshave të rënda, i cili sigurisht kishte marrë ca si shumë goditje në kokë, Leburni kishte përdorur grushtet e tija (e të tjera) për mbledhjen e borxheve me interesa shumë të larta, për zhvatjen e parave me kërcënime, në luftën për territore, në goditjen e sindikatave, çfarë të duash. Pasi njëra nga familjet rivale i bëri një rrahje brutale të veçantë, shefat e tij të krimit, të cilët e respektonin llojin e besnikërisë së Leburnit, sepse ishte shumë e ngjashme me budallallëkun, i kishin dhënë një armë dhe e kishin lënë të bënte detyrën për të qëlluar armiqtë e tyre me një forcë fizike më të vogël, pra me pak fjalë, Monte Leburni ishte bërë një njeri vrasës i nivelit të mesëm. Ai nuk ishte i mprehtë apo i zgjuar, por në të vërtetë, kur rrije dhe mendoje për të, mendoje se sa i zgjuar duhet të jesh për të qëlluar me armë një njeri?

- Ai është brenda dhe jashtë, - shpjegoi infermierja Steineri.

Kejti iu afrua krevatit. Infermierja Steiner qëndroi disa hapa pas saj.

- Mund të na lësh pak vetëm? - pyeti Kejt.

Buzëqeshje e ëmbël. Zëri melodik e ngjethës iu përgjigj:

- Jo, e dashur, nuk mundem.

Kejti i hodhi një vështrim nga sipër Leburnit dhe për një moment u përpoq të gjente në vetvete ndonjë shenjë dhembshurie për njeriun që i kishte vrarë babanë. Në qoftë se ekzistonte, duhet të ishte fshehur me të vërtetë mirë. Shumicën e ditëve, urrejtja e saj për këtë njeri ishte e zjarrtë, por ndonjëherë asaj i dukej se ishte njësoj sikur të urreje një armë. Ai ishte arma. Asgjë më shumë.

Sigurisht, edhe armët duhet të shkatërrohen, apo jo?

Kejti e vuri njërën dorën mbi shpatullën e Leburnit dhe e shkundi lehtë. Sytë e Leburnit u hapën të zgurdulluar.

- Përsëndetje, Monte.

Atij iu desh një moment, që sytë t'i përqendroheshin në fytyrën e Kejtit. Kur u përqendruan, kur e njohu, trupi i ngriu në vend.

- Nuk duhet të jesh këtu, Kejt.

Kejti futi dorën në xhep dhe nxori që andej një fotografi.

- Ky ka qenë babai im.

Leburni e kishte parë atë fotografi shumë herë më përpara. Kejti e kishte sjellë sa herë që i kishte ardhur për vizitë. Ajo nuk ishte e sigurt pse. Një pjesë e saj shpresonte që ai të dorëzohej, por ata që ekzekutojnë njerëz rrallëherë i nënshtrohen pendimit. Ndoshta ajo

e kishte sjellë atë për vete, në njëfarë mënyre, për ta bërë më të fortë vendosmërinë e saj, për të pasur, në një mënyrë të çuditshme, babanë e saj si mbështetje.

- Kush e donte të vdekur atë? Ishte Kozone, apo jo?

Leburni po rrinte me kokën të mbështetur në jastëk.

- Pse vazhdon të më bësh të njëjtat pyetje?

- Sepse ti asnjëherë nuk u je përgjigjur pyetjeve të mia.

Monte Leburni buzëqeshi me dhëmbët e tij si kunja. Edhe në këtë largësi, ajo mund ta nuhaste kalbëzimin në frymëmarrjen e tij.

- Dhe pastaj, çfarë? Po shpreson për ndonjë rrëfim në shtratin e vdekjes?

- Nuk ka asnjë arsye për të mos thënë të vërtetën tani, Monte.

- Patjetër që ka.

E kishte fjalën për familjen e tij. Ajo ishte çmimi i tij, sigurisht. Rri i qetë dhe ne do të kujdesemi për familjen tënde. Hape gojën dhe ne do t'i shkërmoqim copa-copa.

Shpërblim dhe ndëshkim.

Ky kishte qenë gjithmonë problemi i saj. Nuk kishte asnjë gjë për t'i ofruar.

Nuk duhej të ishte doktor, për të kuptuar se Monte Leburnit nuk i kishte mbetur shumë kohë. Vdekja tashmë ishte rehatuar brenda tij dhe kishte filluar të kapej me kthetra në rrugën e saj drejt fitores së pashmangshme. E gjithë qenia e Montes ishte e fundosur, sikur po zhdukej në fund të krevatit dhe pastaj të dyshemesë dhe pastaj, puf, do të shuhej përfundimisht. Ajo i nguli

sytë në dorën e tij të djathtë, dora ku mbante armën, e mbushur me damarë të trashë, të lirshëm, që dukeshin si tubat e një kopshti të vjetër. Serumini intravenoz e kishte të ngjitur pranë kyçit të dorës.

Ai kërciti dhëmbët sikur mes tyre po kalonte një shkull i freskët dhimbjeje.

- Ik, - u mundua të thoshte.

- Jo.

Kejti mund të mendonte se po i ikte mundësia e fundit.

- Të lutem, - i tha ajo duke u përpjekur të përmbante lutjen në zërin e saj. - E kam të nevojshme ta di.

- Ik tutje.

Kejti u përkul më afër tij.

- Dëgjo, në rregull? Kjo është vetëm për mua. E kupton? Kanë kaluar tetëmbëdhjetë vjet. Duhet ta di të vërtetën. Kjo është e gjitha. Për ta mbyllur. Pse urdhëroi ai që të quellohet babai im?

- Rri larg meje.

- Do të them që ke folur.

- Si?!

Kejti tundi kokën, duke u përpjekur të tregonte që ishte e vendosur.

- Në momentin kur të vdesësh, unë do ta arrestoj. Do t'i them që ti u rrëfeve plotësisht.

Monte Leburni qeshi përsëri dhe tha:

- Përpjekje interesante.

- Ti mendon se nuk do ta bëj?

- Nuk e di se çfarë do të bësh ti. Unë di vetëm që askush nuk ka për të të besuar.

Monte Leburni vështroi prapa saj drejt infermieres Steiner dhe tha:

- Dhe e kam një dëshmitare, apo jo Silvia?

Infermierja Steineri pohoi me kokë:

- Jam këtu, Monte.

Një shkulum dhimbjeje e bëri atë të dridhet.

- Jam vërtet i lodhur, Silvia. Po bëhem sa vjen e më keq.

Infermierja Steineri lëvizi me shpejtësi më afër krevatit të tij.

- Jam këtu, Monte, - ajo kapi dorën e tij. Me atë lloj makijazhi shumë të ndezur, buzëqeshja e saj dukej tamam si e pikturuar, si diçka në fytyrën e një klouni të frikshëm.

- Të lutem Silvia, i thuaj të ikë.

- Ajo do të ikë tani.

Infermierja Steineri filloi të shtypë pompën, duke i lëshuar një lloj qetësuesi në damarët e tij.

- Ti vetëm qetësohu Monte, dakord?

- Mos e lër të qëndrojë.

- Shëëëët, do të bëhesh mirë.

Infermierja Steineri i hodhi Kejtin një vështrim keqdashës dhe tha:

- Ajo është aq e mirë sa do të ikë.

Kejti ishte pothuajse duke protestuar, por infermierja Steineri kishte shtypur përsëri në aparatin e perfuzionit duke prerë shkurt çdo diskutim. Sytë e Leburnit kishin filluar të dridheshin. Pak momente më vonë, ai ishte pa ndjenja.

Ajo po humbiste kohë kot.

Por, përsëri, çfarë priste Kejti? Edhe njeriu që ishte duke vdekur ishte tallur me idenë e rrëfimit në shtratin e vdekjes. Kozone e dinte se si t'ua mbante gojën kyçur punëtorëve të tij. Ti bëj punën tënde, familja jote do të ketë perkujdesje për gjithë jetën. Po fole, të gjithë do të vdesin. Nuk kishte asnjë stimul që ta bënte Leburnin të fliste. Asnjëherë s'kishte pasur. Sigurisht që tani s'kishte më.

Kejti kur po drejtohej te makina, dëgjoi një zë tepër të ëmbël nga mbrapa.

- E trajtove shumë keq, e dashur.

Kejti u kthye për të parë infermiere Steinerin që, me veshjen e saj prej infermiereje dhe makijazhin e bojatisur, po rrinte aty dhe dukej si ndonjë gjë që kishte dalë nga një film horror.

- E po, faleminderit për ndihmën.

- E do ndihmën time?

- Më fal?

- Ai ka shumë pak brejtje të ndërgjegjes, ti e di. Dua të them, brejtje të vërtetë të ndërgjegjes. Aty vjen një prift dhe ai i thotë fjalët e duhura. Por, nuk i ka me të vërtetë. Vetëm po përpiket t'i hapë vetes rrugën për në parajsë. Zoti nuk mashtrohet aq lehtë.

Ajo bëri përsëri atë buzëqeshjen ngjethëse, me të kuqin e buzëve në dhëmbë.

- Monte ka vrarë shumë njerëz, apo jo?

- Ai u rrëfye që kishte vrarë tri veta. Por, kanë qenë më shumë.

- Përfshirë babanë tënd?

- Po.

- Edhe babai yt ka qenë oficer policie? Si ti?

- Po.

Infermierja Steineri lëshoi një ncuq-ncuq dhe tha:

- Më vjen shumë keq.

Kejti nuk tha asgjë.

Infermierja Steineri përmblodhi për një moment buzën e poshtme të lyer me të kuq.

- Të lutem, më ndiq.

- Çfarë?

- Ty të duhet informacion, apo jo?

- Po.

- Të lutem mos bjer në sy. Më lër mua të merrem me këtë.

Infermierja Steineri u kthye dhe u nis drejt spitalit. Kejti nxitoi për ta arritur dhe i tha:

- Prit, çfarë ke ndër mend të bësh?

- Di ndonjë gjë për gjumin në muzg? - pyeti infermierja Steineri.

- Në fakt, jo.

- Unë e kam filluar karrierën duke punuar për një gjinekolog. Kohë më përpara, përdornim morfinë dhe skopolaminë si anestezi. Ajo krijonte një gjendje gjysmë të narkotizuar, nëna e ardhshme qëndronte zgjuar, por në fakt nuk do të mbante mend asgjë. Disa thoshin se ajo e mpinte dhimbjen. Ndoshta e hiqte vërtet, por unë nuk mendoj kështu. Mendoj se ajo që ndodhte kishte të bënte me faktin që nëna e ardhshme e harronte agoninë që ishte e detyruar të duronte, -

ajo e anoi kokën, si një qen që dëgjon një zhurmë të çuditshme. - A ka dhimbje kur ti nuk e mban mend atë?

Kejtit iu duk sikur pyetja ishte retorike, por infermierja Steineri ndaloi dhe po priste përgjigjen.

- Nuk e di.

- Mendoje njëherë. Për çfarëdolloj rasti, të mirë apo të keq. Në qoftë se nuk e mban mend menjëherë pasi ka ndodhur, a ka vlerë në të vërtetë?

Përsëri ajo po priste një përgjigje. Përsëri Kejti tha:

- Nuk e di.

- As unë nuk e di. Është një pyetje interesante, apo jo?

Ku dreqin donte të dilte ajo me këtë muhabet?

- Mendoj se po, - tha Kejti.

- Të gjithë ne duam të jetojmë momentin. E kuptoj këtë gjë. Por, në qoftë se ti nuk je në gjendje ta rikujtosh atë moment, a ka ndodhur me të vërtetë? Unë nuk jam e sigurt. Gjumi i muzgut është një shpikje e gjermanëve. Ata mendonin se do ta bënte lindjen e fëmijëve më të durueshme për nënat. Por e kishin gabim. Ne e ndaluan përdorimin e tij, sigurisht. Fëmijët lindnin të droguar. Kjo ishte arsyeja kryesore, të paktën kjo ishte ajo që deklaroi personeli mjekësor. Ajo u përkul drejt Kejtit, si për t'i thënë ndonjë sekret.

- Por, ta themi mes nesh, unë nuk mendoj vërtet se ishte kjo arsyeja.

- Po, atëherë, pse?

- Nuk kishte të bënte me fëmijët, - infermierja Steiner ndaloi te dera. - Kishte të bënte me nënat.

- Çfarë kishte të bënte me to?

- Edhe ato kishin probleme me procedurën. Gjumi i muzgut iu mundësonte atyre të mos ndienin dhimbje, vërtet, por gjithashtu ato asnjëherë nuk e përjetonin lindjen. Ato hynin në një dhomë dhe gjëja tjetër që mbanin mend ishte se kishin një fëmijë. Nga ana emocionale, ato ndiheshin të shkëputura, nuk e përjetonin lindjen e fëmijës së tyre. Ishte një gjë brengosëse. Ti e mban një fëmijë në bark për nëntë muaj. Sapo ke filluar ta lindësh dhe pastaj, menjëherë, puf.

Infermierja Steiner kërciti gishtat për t'i dhënë rëndësi.

- Pastaj mendohesh nëse ka ndodhur vërtet, - e përfundoi Kejti në vend të saj.

- Ekzakt.

- Ç'lidhje ka e gjithë kjo me Monte Leburnin? Buzëqeshja e infermieres Steiner ishte e ndrojtur.

- Ti e kupton.

Ajo nuk e kuptonte. Apo e kuptonte?!

- Ti mund ta vësh atë në gjumin e muzgut?

- Po, patjetër.

- Dhe ti mendon... "çfarë?", unë mund ta bëj atë të flasë dhe pastaj ai do të harrojë çdo gjë?

- Jo, jo tamam. Dua të them, po, ai nuk do të mbajë mend. Por morfina nuk është edhe aq e ndryshme nga Tiopentali i natriumit. Ti e di se çfarë është ky, apo jo?

Kejti e dinte, megjithëse ai njihej më mirë si *Sodium Pentothal*. E thënë shkurt: serumi i së vërtetës.

- Ai nuk vepron njësoj siç e shikon nëpër filma,

- vazhdoi infermierja Steiner. - Por kur njerëzit janë

keq, dakord, nënat kanë tendencë të dërdëllisin. Madje të rrëfihen. Në më shumë sesa një rast, me bashkëshortin që ecte poshtë e lart në dhomën tjetër, ato rrëfenin që fëmija nuk ishte i tij. Ne nuk i pyesnim, sigurisht. Ato donin vetë t'i thoshin dhe ne bënim sikur nuk i dëgjonim. Por, me kalimin e kohës, fillova të kuptoj që në fakt duhet t'i kushtojë vëmendje bisedave. Ti mund t'i pyesje e të mësoje gjëra shumë të rëndësishme dhe, sigurisht, atyre nuk do t'u kujtohej asnjëherë, asnjë gjë.

Infermierja Steiner e pa Kejtin në sy. Kejti ndjeu një drithërimë që t'i përshkonte shpinën nga lart-poshtë. Infermierja Steiner i hoqi sytë dhe e hapi derën duke e shtyrë.

- Gjithsesi, më duhet të them se ka një problem shumë të madh me besueshmërinë. E kam parë të ndodhë shumë herë me morfinën. Pacienti do të flasë me bindje për diçka që është e pamundur për të qenë e vërtetë. Njeriu i fundit që ka vdekur në këtë spital, betohej se, sa herë që e lija vetëm, e rrëmbente dikush dhe e çonte në funerale të ndryshme macesh. Ai nuk gënjente. Ishte i bindur që ndodhte kështu. E kupton?

- Po.

- Atëherë, ti po më kupton. Do të vazhdojmë?

Kejti nuk dinte ç'të bënte. Ajo ishte rritur në një familje polici. I kishte parë rreziqet e shkeljes së rregullave.

Por, çfarë zgjidhje kishte?

- Detektive?

- Shko përpara, - tha Kejti.

Buzëqeshja i shkoi vesh më vesh.

- Në qoftë se Monte do ta dëgjojë zërin tënd, do t'i zgjohen shqisat e mbrojtjes. Nëse më lë mua që të merrem me të, ndoshta mund të marrim ndonjë informacion të vlefshëm për ty.

- Dakord.

- Më duhen disa të dhëna lidhur me të shtënat.

Zgjati rreth njëzet minuta. Infermierja Steiner shtoi *Scopolamine* në përzierje, kontrolloi shenjat jetësore, bëri rregullimet. Po e bënte këtë me duar shumë të praktikuara, aq sa Kejti për një moment po mendonte nëse kjo ishte hera e parë që infermierja Steiner e kishte bërë për arsye që nuk ishin thjesht mjekësore. Kejti nuk mund ta ndihmonte, por po mendonte për ndërlikimet e gjumit të muzgut, mundësitë për abuzime. Justifikimi gazmor që kishte bërë infermierja Steiner - nëse nuk e mban mend ç'ka ndodhur, a ka ndodhur vërtet? - dukej shumë i lehtë.

Gruaja doli jashtë. Tani, nuk kishte asnjë dyshim që kjo grua nuk ishte pa gjë, por Kejti nuk bëhej shumë merak.

Kejti u ul përdhe, në një qoshe, ku nuk dukej. Monte Leburni ishte ngritur tani, me kokën të mbështetur nga mbrapa në jastëk. Ai filloi ta thërrasë infermieren Kasi, me emrin e motrës së tij që kishte vdekur kur kishte qenë tetëmbëdhjetë vjeçe. Filloi t'i thotë sesa shumë donte që ta shikonte pasi të vdiste. Kejti po çuditej sesi infermierja Steiner dukej se po e

çonte atë thellë e më thellë në rrugën ku ajo donte që ai të shkonte.

- Oh, do të më shikosh Monte, - tha infermierja Steiner. - Do të të pres në anën tjetër. Po vetëm se mund të ketë disa probleme me njerëzit që ke vrarë.

- Burra, - tha ai.

- Çfarë?

- Kam vrarë vetëm burra. Nuk do të vrisja asnjë grua. Asnjëherë. As gra, as fëmijë Kasi. Kam vrarë burra. Burra të këqij.

Infermierja Steiner hodhi një vështrim drejt Kejtit.

- Por, ke vrarë edhe një oficer policie.

- Më i keqi nga të gjithë.

- Çfarë do të thuash?

- Polica. Ata nuk vlejné asgjë. Megjithatë s'ka rëndësi.

- Nuk të kuptoj, Monte. Ma shpjego.

- Nuk kam vrarë kurrë ndonjë polic, Kasi. Ti e di këtë.

Kejti ngriu. Kjo nuk mund të ishte e drejtë.

Infermierja Steiner pastroi fytyrën.

- Por, Monte...

- Kasi? Më vjen keq që nuk të mbrojta kurrë, - Monte Leburni filloi të qajë. - E lashë të të bënte keq dhe nuk bëra asgjë për të të ndihmuar.

- Në rregull, Monte.

- Jo, nuk është në rregull. Mbrojta gjithë të tjerët, dakord? Por ty jo.

- Ka marrë fund tani. Tani jam në një vend më të mirë. Dua që të jesh këtu me mua.

- Po mbroj familjen time tani. E kam mësuar. Babai nuk ishte i mirë.

- E di këtë. Por, Monte, më the që nuk ke vrarë asnjëherë ndonjë polic.

- Ti e di këtë.

- Po për detektivin Henri Donovan?

- Shëëët.

- Çfarë?

- Shëëët, - tha ai. - Do të të dëgjojnë ata. Ishte e thjeshtë. Gjithsesi unë i djegur isha.

- Çfarë do të thuash?

- Ata tashmë më kishin kapur për vrasjen e Lazlout dhe Grinit. Vrasje të provuara. Sidoqoftë, unë do të burgosesha përjetë. Çfarë është një më shumë, nëse ta vënë kusht, më kupton ç' dua të them?

Një dorë e ftohtë u mbështoll rreth zemrës së Kejitit dhe e shtrëngoi.

Madje edhe infermierja Steiner mezi po e mbante tonin e zërit të saj.

- Ma shpjego, Monte. Pse e qëllove detektivin Donovan?

- Kështu mendon ti? Unë vetëm sa e pranova fajin. Isha i mbaruar. Nuk e kupton?

- Nuk e ke qëlluar ti atë?

Asnjë përgjigje.

- Monte?

Ajo po fillonte ta humbiste.

- Monte, nëse nuk ke qenë ti, kush e vrau atë?

Zëri i tij dukej shumë i largët.

- Kush?

- Kush e vrau, Henri Donovanin?

- Si mund ta di unë? Ata më erdhën për vizitë. Një ditë pasi isha arrestuar. Më thanë t'i merrja paratë dhe ta pranoja fajin.

- Kush?

Sytë e Montes u mbyllën.

- Jam kaq përgjumësh.

- Monte, kush të tha që ta pranosh fajin?

- Nuk duhet ta kisha lënë kurrë babanë që të ikte me të. Babai nuk duhej t'ia hidhte paq, Kasi. Për atë çka të bëri ty. Unë e dija. Mamaja e dinte. Dhe ne nuk bëmë asgjë. Më vjen keq.

- Monte?

- Kaq i lodhur...

- Kush të tha që ta marrësh përsipër fajin?

Por Monte Leburni kishte rënë në gjumë.

GJATË rrugës së kthimit, Kejti i mbante të dyja duart në timon. Ishte përqendruar shumë në rrugë, shumë fort, por kjo ishte e vetmja mënyrë për të mbajtur mendjen në vend. Bota e saj kishte dalë nga aksi. Infermierja Steineri e kishte paralajmëruar përsëri që Monte Leburni ishte i çorientuar nga ilaçi dhe se thëniet e tij duhet të shikoheshin me një dozë të fortë skepticizmi. Kejti pohonte me kokë kur infermierja fliste. Ajo kuptonte gjithçka; çorientimin dhe pabesueshmërinë, madje edhe imagjinatën, por ajo kishte mësuar një gjë si police: E vërteta e ka aromën kutërbuese.

Pikërisht tani, Monte Leburni qelbej nga e vërteta.

Ajo ndezi radion dhe po përpiquej të dëgjonte emisionet me biseda të irrituara. Të ftuarit jepnin përgjigje mjaft të thjeshta për problemet e botës. Kejtit

iu duk acaruese thjeshtësia e tyre dhe rrjedhimisht emisioni i tyre që, në mënyrë të çuditshme, ia hiqte mrekullisht mendjen. Ata që jepnin përgjigje të thjeshta, qofshin në anën e djathë apo të majtë, e kishin gjithmonë gabim. Bota ishte komplekse. Asnjëherë nuk kishte një masë që të mund ta vishnin të gjithë.

Kur mbërriti në kthim në *19th Precinct*, u drejtua menjëherë në zyrën e kapitenit Stager. Ai nuk ishte aty. Mund të pyeste se kur do të kthehej, por ende nuk mendonte që të tërhiqte vëmendjen. Vendosi t'i dërgonte atij një mesazh të shpejtë.

Kam nevojë të flasim.

Ai nuk iu përgjigj menjëherë, por sidoqoftë, Kejt i nuk e priste një gjë të tillë. U ngjiti një kat më lart. Partneri i saj aktual, Çarls, “Çaz” Feirklothi, po rrinte në qoshe me tre policë të tjerë. Kur ajo u afrua, Çazi tha:

- Hej, ç’kemi, Kejt, - duke e zgjatur zërin, aq sa edhe këto fjalë dashamirëse kishin një sarkazëm therës. Pastaj, meqë Çazi kështu ishte, shakaxhi, shtoi: - Shikoni çfarë po heq zvarrë macja (Kat).

Fatkeqësisht, shokët e tij shpërthyen në të qeshura.

- E mirë, - tha ajo. - Faleminderit që punove në turnin tim.

- Ia vlen.

Oh, tani ajo nuk ishte fare në humor për shakatë e tij.

Çazi kishte veshur një kostum të shtrenjtë, prej damasku, të qepur në mënyrë të përsosur, nga ai lloj që shkëlqen sikur është i lagur, një kravatë të lidhur

në stilin Uindsor nga dikush që e kishte kohën me shumicë dhe këpucë “Ferragamo”, që të kujtonin atë proverbin e vjetër se një njeri duhet ta gjykoshe nga shkëlqimi i këpucëve të tij. Proverbi ishte një broçkull. Djemtë që i lustronin gjithmonë këpucët e tyre, zakonisht ishin ca legenë të kapardisur ku dukej që cektësia mposhte thelbin e tyre.

Çazi kishte pamjen e llakosur, të djalit të bukur, që dukej mirë dhe një karizëm pothuajse të mbinatyrshme prej, le të themi, psikopati. Kejti dyshonte se ai ishte pikërisht i tillë. Ai ishte një Feirkloth, po, një *prej* Feirklothëve, një familje e pasur dhe me shumë lidhje, anëtarët e së cilës shpesh luanin sikur ishin policë, sepse dukej mirë kur vraponin për të marrë poste publike. Ende duke i pasur sytë mbi të, Çazi iu pëshpëriti një shaka të vogël çunave, ndoshta në kurriz të saj dhe grupi u shpërnda duke qeshur.

- Je me vonesë, - i tha Çazi asaj.

- Po punoja për një çështje të kapitenit.

Ai ngriti njërën vetull.

- Është e njëjta çështje për të cilën e thirrën?

Çfarë idioti.

Me Çazin, çdo gjë kishte kuptim të dyfishtë që kufizohej, nëse nuk e kaloje, me ngacmimin. Nuk ishte çështja se ai i gjuante gratë. Ishte se i gjithë personaliteti i tij i gjuante gratë. Disa burra janë kështu - ata komunikojnë me të gjitha femrat sikur sapo janë takuar në një bar beqarësh. Ai fliste me lajka edhe për faktin se çfarë kishte ngrënë në mëngjes, a thua se ti kishe kaluar një natë me të dhe ia kishe gatuar enkas.

- Atëherë, me çfarë pune po merremi? - pyeti Kejti.
- Mos u shqetëso. E kam mbuluar unë pjesën tënde.
- Po, dakord, por e ke problem të më japësh edhe mua ca?

Çazi bëri me shenjë drejt tavolinës së saj, duke bërë të shndrisnin butonat me gurë smeraldi të këmishës.

- Të gjitha dosjet i ke atje. Merri, - ai pa orën e tij të stërmadhe dhe shumë të ndritshme "Roleks". - U fryva.

I kapardisur si gjel, ai doli duke fishkëllyer një melodi idiote për shkurtabiqë në një klub. Kejti tashmë kishte folur me Stefan Singerin, eprori i saj i drejtpërdrejtë, për të marrë një partner të ri. Sapo Çazi dëgjoi për kërkesën e saj, u trondit, jo aq shumë ngaqë i pëlqente vërtet Kejti, por sepse ai nuk mund ta kuptonte si kjo grua, ose çdo grua, nuk ishte tërhequr nga magjia e tij. Ai reagonte duke e rritur hijeshinë e tij, i sigurt se nuk kishte asnjë grua, në asnjë vend të botës së lirë, të cilën ai nuk mund ta sillte vërdallë sipas tekave të veta.

Pa u kthyer nga ajo, Çazi tundi njërën dorë përpjetë dhe tha:

- Mirupafshim, më vonë zogu.

Nuk ia vlen, tha ajo me vete.

Kishte në duar çështje më të rëndësishme. Për shembull: A mund të kishte thënë të vërtetën Monte Leburni?

Po sikur ata ta kenë pasur gabim gjatë gjithë këtyre viteve? Po sikur vrasësi i babait të saj të ishte ende jashtë?

Kjo gjë ishte pothuajse shumë e madhe për t'u marrë parasysht. Ajo kishte nevojë të zbrazej, të fliste me dikë që i njihte të gjithë lojtarët dhe situatat, dhe emri i parë që i erdhi në mend, personi i parë që i tha koka, Zoti e ndihmoftë atë, ishte Xhef Reinsi.

Ajo hodhi një vështrim mbi kompjuterin në tavolinën e saj.

Në fillim gjërat më të rëndësishme. Ajo mori çdo dosje për Monte Leburnin dhe vrasjen e detektivit Henri Donovan. Kishte një mori materialesh. Në rregull, bukur. Ajo mund t'i lexonte në shtëpi sot në mërmëje. Sigurisht, tashmë i kishte lexuar me qindra herë, por gjithmonë kishte qenë me mendimin se Monte Leburni ishte njeriu fajtor? Jo. Me sy të freskët. Ajo duhet t'i lexonte me sy të freskët.

Pastaj filloi të mendonte nëse Xhefi i ishte përgjigjur mesazhit të saj në *YouAreJustMyType.com*.

Tavolina në të dyja anët e saj ishte bosh. Vështroi pas vetes. Askush nuk ishte aty. Bukur. Në qoftë se çunat do ta shikonin duke hyrë në një faqe për takime *online*, ajo asnjëherë nuk do të mund ta mbyllte atë çështje. U ul në kompjuter dhe hodhi një vështrim tjetër. Horizonti ishte i pastër. Shtypi me shpejtësi *YouAreJustMyType.com* në ekran dhe pastaj shtypi butonin *RETURN*.

Faqja është e bllokuar. Për t'u futur, ju lutemi të kontaktoni me eprorin tuaj, për kodin e hyrjes.

Oh, e pamundur! Departamenti i policisë ishte si shumica e bizneseve që përpiqeshin të rrisnin produktivitetin duke mos i lejuar punonjësit që të harxhonin kohën me faqet personale të internetit në rrjetet sociale. Kjo ishte ajo që po ndodhte këtu.

Më përpara ajo ishte përpjekur shumë për të vendosur aplikacionin *YouAreJustMyType* në telefonin e vet, por kjo dukej një mënyrë shumë e dëshpëruar. Ajo vetëm duhej të priste. Gjë që ishte në rregull. Vetëm se nuk ishte në rregull.

Rastet po hynin nëpër derë. Kejti po merrej me to. Një shofer taksie pretendonte se një personalitet shoqëror ishte përpjekur të kundërshtonte tarifën. Një grua ishte ankuar se fqinji i saj po rriste bimë në tenxhere. Gjëra të vogla. Ajo kontrolloi telefonin. Asnjë përgjigje nga Stageri. Nuk dinte si t'ia bënte kësaj pune. I dërgoi atij edhe një mesazh tjetër.

Kam vërtet nevojë të flas me ty.

Ishte duke e futur në xhep telefonin, kur ndjeu dridhjen e tij. Kishte ardhur përgjigjja e Stagerit.

Kam përshtypjen se ka të bëjë me vizitën në burg?

Po.

Këtë radhë, vonesa ishte më e gjatë.

Jam i zënë deri në orën tetë. Mund ta lëmë për në mbrëmje apo të presim deri në mëngjes.

Nga ana e Kejtit nuk kishte vonesa.

E LËMË PËR NË MBRËMJE.

* * *

KEJTI nuk pretendonte të ishte e paduruar derisa të shihte nëse ishte përgjigjur Xhefi.

Në përfundim të turnit, ajo veshi rrobat e sportit, vrapoi për qark parkut, kaloi me nxitim te roja i derës, buzëqeshi dhe duke e përshëndetur me kokë, i ngjiti shkallët dy e nga dy (ashensori mund të ishte më i ngadaltë) dhe e hapi derën me një lëvizje të qetë.

Kompjuteri ishte në gjendjen *sleep*. Kejti i dha një të tundur mausit dhe priti. Ora e vogël e rërës u shfaq dhe filloi të shkonte poshtë e lart. Për Zotin, asaj i duhej një kompjuter i ri. Ishte e etur nga vrapit dhe po mendohej për të marrë një gotë me ujë, por ora e rërës ndaloi.

Ajo hapi faqen *YouAreJustMyType.com*. Kishin kaluar mjaft orë që nga vizita e saj e fundit, prandaj faqja kishte bërë përsëri mbylljen e saj. Ajo shtypi emrin e saj të përdorimit dhe fjalëkalimin dhe klikoi *continue*. Në ekran u shfaq mirëseardhja me gjashtë fjalë të mëdha, të ndritshme dhe jeshile:

Ke një përgjigje në kutinë e mesazheve!

Zemra e saj po dridhej. Ajo mund ta ndiente atë, zhurmën e ngadaltë, vazhdimisht të mbytur, që dukej sikur e kishte përpara syve. Ajo klikoi në fjalët jeshile. Kutia e mesazheve u hap me fotografinë e vogël të profilit të Xhefit.

O tani, o kurrë.

Linja e subjektit ishte bosh. Ajo e lëvizi kursorin mbi të dhe klikoi për të hapur *email*-in. Mesazhi i Xhefit doli:

HA! Video e këndshme! Gjithmonë e kam pëlqyer. Njoh njerëz që thonë se e duan gruan me sens humori, por kjo është një mënyrë e zgjuar për ta pasur. Më kanë tërhequr gjithashtu edhe fotografitë e tua, fytyra jote është e bukur, pa dyshim, por ka diçka në të... diçka tjetër. Ishte gjë e bukur që kontaktuam bashkë!

Kjo ishte gjithçka. Pa nënshkrim. Pa emër.

Asgjë.

Prit, si?

E vërteta iu përplas fuqishëm në fytyrë. Xhefi nuk e mbante mend.

Si ishte e mundur? Si mund të mos e mbante mend atë? E mbajti telefonin, duke u përpjekur të mos dalë nga vetja. Ajo mori frymë thellë dhe u përpoq të mendonte për të. Dakord, në fund të fundit, Xhefi nuk e mbante mend. Sa shumë kishte ndryshuar? Goxha, mendoi ajo. Flokët tani i kishte më të errët dhe më të shkurtër. Ishte moshuar. Burrat janë më me

fat, sigurisht. Ngjyra gri në tëmthat e Xhefit vetëm sa e bënte atë më simpatik, dreqi e marrtë. Për të qenë objektive, vitet ndoshta nuk kishin qenë edhe aq të mira me të. Shumë e thjeshtë. Kejti u ngrit, qëndroi drejt, po shikohej në pasqyrë. Nuk mund ta shikosh atë te vetja, sigurisht. Nuk i shikon dot ndryshimet që sjellin vitet. Por tani, duke parë nëpër sirtarët e vet për të gjetur fotografitë e saj të vjetra, flokët e këqij, mollëzat e faqeve të fryra, rininë plot shkëlqim pothuajse e gjeti arsyen. Për herë të fundit ai e kishte parë atë me sy të ndritshëm, megjithëse të dërmuar, njëzet e dy vjeçe. Tani ajo ishte dyzet. Ndryshim i madh. Profili i saj nuk jepte informacion personal të vërtetë. Aty nuk ishte vendosur adresa e saj ose diplomimi në “Columbia” apo ndonjë gjë tjetër që të kuptoje se ishte Kejti.

Pra, normalisht, ishte e arsyeshme që Xhefi të mos e njihnte atë.

Sigurisht, kur filloi të mendonte pak më shumë për atë gjë, ajo po argumentonte se, nëse nuk e prishte, të paktën ta sqaronte disi. Ata kishin qenë të dashuruar. Kishin qenë të fejuar. Ajo këngë, ajo video, kishin qenë më shumë se “të këndshme” për ta, më shumë se diçka që mund ta kalosh ose ta harrosh apo...

Diçka e pengoi vështrimin e saj dhe e mbajti atë.

Kejti u përkul më afër monitorit të kompjuterit dhe pa një zemër që pulsonte pas fotografisë së profilit të Xhefit. Sipas rrjetës së vogël në fund, ajo do të thoshte se ai ishte aktualisht *online* dhe mund të

merrte mesazhe drejtpërdrejt nga “ata të cilët kishin komunikuar më përpara” me të.

Ajo u ul, hapi kutinë e mesazheve të çastit dhe shkroi,

Jam Kejti.

Për ta dërguar, duhej të shtypje butonin *RETURN*. Ajo nuk humbi kohë dhe nuk i dha vetes një mundësi për ta menduar më gjatë. Shtypi butonin *RETURN*. Mesazhi u dërgua.

Kursori po pulsonte i paduruar. Kejti po rrinte dhe po priste përgjigjen e tij. Këmba e saj e djathtë po lëvizte si çekan poshtë e lart. Asnjëherë nuk ishte diagnostikuar me sindromën e këmbës nervoze, por po mendonte se ishte në kufijtë e saj. Edhe babai i saj e lëvizte këmbën gjithashtu. Shumë. Ajo e vuri dorën mbi gju dhe donte ta mbante veten. Sytë nuk i hoqi asnjëherë nga ekrani.

Kursori që pulsonte u zhduk. U shfaq një re e vogël.

Kjo do të thoshte se Xhefi e kishte shtypur përgjigjen e tij. Një moment më vonë, përgjigjja u shfaq në ekranin e saj:

Asnjë emër. Të paktën ende jo.

Ajo ngrysi vetullat. Çfarë dreqin do të thoshte kjo? Diku në fund të mendjes së saj, iu kujtua se kishte lexuar diçka gjatë “orientimit” të saj fillestar në faqen *YouAreJustMyType.com*, njëfarë paralajmërimi për

përdoruesit, të cilët nuk duhet të përdorin emrat e tyre të vërtetë derisa të ishin të sigurt se personi ishte dikush që ata donin ta takonin personalisht.

Pra, ai nuk ishte i sigurt?

Çfarë po ndodhte këtu? Gishtat e saj gjetën tastierën dhe filluan të shtypin:

Xhef? Ti je? Jam Kejti.

Kursori pulsoi ekzaktësisht dymbëdhjetë herë, i numëroi, dhe pastaj zemra e kuqe që rrihte u zhduk.

Xhefi ishte shkëputur nga lidhja.

PO sikur ai të ishte Xhefi.

Ky ishte mendimi tjetër që i erdhi papritur në mendje. Ndoshta burri i ve në profil nuk ishte Xhefi. Ndoshta ai ishte vetëm një djalë që ngjante si ish-i fejuari i saj. Fotografitë, tani që po i shikonte nga fillimi, ishin të turbullta. Shumica e pozave ishin të bëra jashtë, në njëfarë largësie. Njëra ishte në një pyll, një ishte në një plazh të shkretë me një gardh të prishur, një ishte diku që dukej si fushë golfi. Në disa prej tyre, kishte vënë kapelë bejsbolli. Në disa të tjera kishte vënë edhe syze dielli (asnjëherë në mjedise të brendshme, lavdi Perëndisë). Njësoj si Kejti në fotografitë e saj. Xhefi i mundshëm asnjëherë nuk dukej krejtësisht i qetë, gati-gati sikur po fshihej apo se mos kapej pa mendje, ose po shmangte fotografimin, i cili i kishte vënë qëllim vetes që ta fuste edhe atë në fotografi, gjithsesi.

Si police, nga përvoja, ajo kishte mësuar fuqinë e arsyes, të sikletit, të mosbesimit të syve, të memories vizuale përballë sugjestionimit. Ajo kishte parë dëshmitarë që e nxirrnin një person në linjën ku ata, policët, donin që ai të dilte. Truri yt mund të të mashtrojë me disa ngacmime të thjeshta.

Çfarë mund të bënte ajo me gjithë këtë siklet?

Natën e kaluar, i kishte hedhur një sy të shpejtë një faqeje interneti duke kërkuar për shokun e jetës. A nuk kishte më shumë gjasa që ajo ta ringjallte burrin e vetëm që kishte pasur aq pranë në jetë, sesa faktikisht ta shikonte atë përsëri?

Citofonia e portierit gumëzhiti.

Ajo shtypi butonin.

- Po, Frank?

- Ka ardhur kapiteni yt.

- Lëre të vijë lart.

Kejti e la derën të hapur me qëllim që Stageri të hynte drejt e brenda pa trokitur se gjëja e fundit që donte ishin shkëndija kujtimesh nga ajo ditë tetëmbëdhjetë vjet të shkuar. Doli nga faqja *YouAreJustMyType.com* dhe për të qenë e sigurt fshiu historikun e kërkimeve të saj.

E gjithë qenia e Stagerit transmentonte rraskapitje. Sytë i kishte të skuqur dhe të këputur. Qimet e mjekrës së rruar në mëngjes nxinin si të kishte kaluar mesnata. Supet i kishin rënë posi të një shpendi grabitqar shumë të lodhur pas ndjekjes së presë së vet.

- Je mirë? - e pyeti ajo.

- Ditë e gjatë.

- Të të sjell ndonjë gjë për të pirë?

Ai tundi kokën.

- Ç'ka ngjarë?

Kejti kishte vendosur që të hynte drejt e në temë dhe tha:

- Sa i sigurt je që Henrin e ka vrarë Monte Leburni?

Çfarëdolloj gjëje kishte pritur t'i thoshte ajo, çfarëdo hamendësimi kishte bërë për arsyen përse ajo donte me aq dëshpërim të bisedonte me të, por këtë nuk e priste.

- E ke seriozisht?

- Po.

- Kam përshtypjen se kishe për ta takuar sot?

- Po.

- Dhe si, papritur, ai mohoi që ta këtë qëlluar babanë tënd?

- Jo tamam.

- Po çfarë?

Këtu Kejti duhet të ishte e kujdesshme. Stageri nuk ishte sipas rregullave të një libri, ai ishte vetë libri, lidhja, faqet, shtypshkrimi, i gjithë procesi. Në qoftë se ai do të dëgjonte për infermieren Steiner dhe për gjumin e muzgut do të nevríkosej dhe do të bënte namin.

- Dakord, dua që të më dëgjosh një sekondë, - filloi ajo. - Vetëm më dëgjo me vëmendje, dakord?

- Kejt, të dukem në humor për gallatë?

- Jo. Patjetër që jo.

- Më thuaj, pra, si është puna.

- E mora vesh, por vetëm më ndiq. Le t'i kthehem i që nga fillimi.

- Kejt...

Ajo filloi të flasë:

- Këtu është Monte Leburni është një vrasës, dakord? Federalët e gozhduan atë si autor të dy vrasjeve. Ata u përpoqën që ta bënë të fliste për Kozonen. Ai nuk foli. Nuk është nga ai lloj tipi që ta bëjë këtë. Ndoshta është shumë gojëkyçur. Ose mendon se ata do t'i vrasin familjen. Sidoqoftë. Leburni e qepi.

Ajo priti që ai t'i thoshte të dilte në temë. Ai nuk e bëri.

- Ndërkohë, çunat po kërkonin se kush e kishte vrarë babanë tim. Ju nuk kishit asgjë, vetëm thashetheme dhe disa fije të shkëputura dhe papritmas, fap, Leburni rrëfëhet.

- Nuk ishte kështu, - tha Stageri.

- Po, kështu ishte.

- Ne kishim disa pista.

- Por asnjë gjë të fortë. Kështu më ke thënë, pse u rrëfye ai kaq papritur?

Stageri shtrembëroi fytyrën.

- Ti e di pse. Kishte vrarë një polic. Presioni ishte qesharak në operacionin. Laku po shtrëngohej rreth Kozones. Ai po na e fuste me diçka.

- Pikërisht. Prandaj Monte Leburni e pranoi fajin. Dhe Kozone shpëtoi nga kjo histori. Sa e volitshme. Një djalë që tashmë po e kalon jetën në burg, merr edhe një dënim tjetër të përjetshëm.

- Ne u përpoqëm për vite të tëra që ta mbërthejmë Kozonen për këtë gjë. Ti e di këtë.

- Dhe ju e dini përse nuk ka qenë asnjëherë e mundur të bëhet lidhja mes Kozones dhe Leburnit bashkë për këtë çështje?

Ai psherëtiu.

- Ti nuk je duke më ngatërruar në ndonjë një konspiracioni, apo jo, Kejt?

- Jo.

- Arsyeja pse nuk mundëm t'i lidhim ata bashkë në këtë gjë është shumë e thjeshtë. Kjo është mënyra si funksionon bota. Nuk është një sistem i përsosur. Ose ndoshta, - tha Kejt duke u përpjekur të mbante zërin të qetë, - ndoshta nuk mund t'i lidhim së bashku, sepse Monte Leburni nuk e kishte qëlluar babanë tim. Ne mundëm që ta lidhnim Leburnin në mënyrë të pavarur me të dyja vrasjet e tjera. Por asnjëherë nuk mundëm ta lidhim me babanë. Pse? Dhe pse nuk ishim asnjëherë në gjendje që të identifikonim ato gjurmët e gishtave? A nuk e pyet veten se kush tjetër ka qenë në vendin e ngjarjes?

Stageri vetëm po shikonte.

- Çfarë ndodhi në "Fishkill"?

Kejt e dinte që këtë pjesë duhet ta luante me kujdes.

- Ai është keq.

- Leburni?

Ajo pohoi me kokë.

- Nuk mendoj se ka më shumë jetë se një javë apo dy.

- Prandaj shkove ti, - tha Stageri. - Dhe ai pranoi të të takojë.

- Në njëfarë mënyre.

Ai i hodhi asaj një vështrim mosbesues.

- Çfarë do të thotë kjo?

- Ai ishte në infirmieri. Fola sipas mënyrës sime për të hyrë. Pa e ekzagjeruar, pa hile. Nxora distinktivin, nuk e tregova plotësisht.

- Dakord, pastaj?

- Pastaj kur shkova te shtrati i Leburnit, ishte vërtet në gjendje shumë të keqe. E kishin droguar me doza të mëdha qetësuesish. Morfinë, ma merr mendja.

Sytë e Stagerit u ngrysen.

- Dakord, pastaj?

- Pastaj ai filloi të murmuriste. Nuk e pyeta, ai nuk ishte një gjendje për këtë. Ishte pothuajse i tëri në atë botë. Fliste në mënyrë të pavetëdijshme. Mendonte se infirmierja ishte motra që i kishte vdekur, Kasi. Po i kërkonte të falur që e kishte lënë të atin të abuzonte me të a diçka të ngjashme. Filloi të qajë dhe t'i thotë asaj se shumë shpejt do të ishte me të. Gjëra të tilla.

Stageri e kishte mbërthyer me sy. Ajo nuk ishte e sigurt nëse ai po blinte ndonjë gjë, por nga ana tjetër, as nuk ishte e sigurt sesa me vështirësi po ia shiste.

- Vazhdo, - tha Stageri.

- Dhe ai tha që nuk kishte vrarë asnjëherë ndonjë polic.

Sytë e tij sikur u zgurdulluan. Kjo nuk ishte plotësisht e vërtetë, por për hir të kësaj bisede, Kejti mendoi se ishte pothuajse mjaftueshëm.

- Tha se ishte i pafajshëm, - vazhdoi ajo.

Stageri pa me mosbesim.

- Për gjithçka?

- Jo, krejt e kundërta. Ai tha se ata tashmë e kishin marrë duke i provuar dy vrasje, pra, ç'të keqe do të

kishte sikur të pranonte edhe një tjetër nëse ia vinin kusht?

- Nëse ia vinin kusht?

- Kështu tha.

Stageri tundi vetëm kokën.

- Kjo është çmenduri. Ti e di këtë, apo jo?

- Nuk është. Faktikisht ka një kuptim të përsosur.

Tashmë je i dënuar me burgim të përjetshëm. Çfarë është edhe një dënim tjetër për vrasje? - Kejti shkoi një hap më pranë tij. - Le të themi që po mbyll një vrasës. Ndoshta ke ditë, mbase edhe orë për mbylljen e të gjitha gjërave. Papritur, një djalë që sapo është kapur dhe po dënohet me burgim të përjetshëm rrëfeket. E kupton?

- E kush mund ta ketë bërë në të vërtetë këtë gjë?

- Nuk e di. Ndoshta Kozone.

- Do ta përdorte ai njeriun e vet?

- Një njeri që ai e njeh, por edhe ne e njohim, a do të fliste ndonjëherë? Sigurisht, pse jo?

- Ne kemi armën e vrasjes, të kujtohet?

- Po.

- Armën që qëllloi babanë tënd. Ne e gjetëm tamam aty ku tha Monte Leburni se ishte.

- Sigurisht që Leburni e dinte. Vrasësi i vërtetë ia ka thënë. Vraje pak mendjen. Që kur një vrasës si Leburni e mban armën? Ai e heq qafe. Ne nuk gjetëm asnjë nga armët e vrasjeve të tjera, apo jo? Papritur, pasi vret një polic, ai vendos ta mbajë atë, për çfarë? Për kujtim? Dhe tjetër, po për ato gjurmët e gishtërinjve? Kishte ndonjë bashkëpunëtor ai? Kishte qenë vetëm? Çfarë?

Stageri i vuri duart në supet e saj.

- Kejt, më dëgjo.

Ajo e dinte se çdo të ndodhte. Kjo ishte pjesë e asaj gjëje. Ajo duhej të dilte nga situata.

- Ti the që Leburni ishte i droguar, apo jo? Me morfinë?

- Po.

- Edhe që kishte halucinacione. Kështu the. Ai murmuriti disa fjalë imagjinare të pakuptimta. Kjo është e gjitha.

- Mos më merr me të qeshur, Stager.

- Jo, nuk po të marr.

- Po, po më merr. Ti e di që unë nuk i ha gjërat e pakuptimta si ajo “mbyllja”, - bëri me gishta shenjën e thonjzave. - Mendoj se është budallallëk. Edhe sikur ne të mbërthejmë këdo që është përzier me vrasjen e tij, babai im nuk do të ngjallet. Kjo nuk do të ndryshojë asnjëherë. Prandaj “mbyllja”, nuk e di, është pothuajse një ofendim për memorien e tij, e kupton se ç’dua të them?

Ai pohoi me ngadalë me kokë.

- Por ai arrestimi... asnjëherë s’ma ka mbushur mendjen. Gjithmonë kam dyshuar se ka diçka më shumë.

- Dhe tani ti ma hap përsëri këtë çështje.

- Çfarë?

- Hajde pra, Kejt. Ai është Monte Leburni. Mendon se ai nuk e di që ti ishe atje? Ai është tallur me ty. Ai e di që ti ke pasur dyshime gjatë gjithë kohës. Ti ke dashur të shohësh diçka që s’ka qenë aty. Dhe tani ai ta ka dhënë këtë gjë.

Ajo hapi gojën për të kundërshtuar, por papritur mendoi për Pothuajse-Xhefin e mundshëm në kompjuterin e saj. Nevoja mund të të ndryshojë mënyrën e të kuptuarit. Ishte kjo pjesë e kësaj? A donte ajo patjetër të gjente një zgjidhje, të gjente “mbylljen”, që po krijonte skenarë?

- Nuk është ashtu, - tha Kejti, por zëri i saj ishte më pak i bindur tani.

- Je e sigurt?

- Duhet të më kuptosh. Nuk mund ta lë të më ikë ky rast.

Ai pohoi ngadalë me kokë.

- E kuptoj.

- Përsëri nuk po më merr seriozisht.

Ai mezi nxori një buzëqeshje të lodhur.

- Monte Leburni e ka vrarë babanë tënd. Nuk është e saktë, apo nuk është shumë bindëse. Asnjëherë nuk ka qenë. Ti e di këtë. Pikëpyetjet për këtë rast, normale të gjitha dhe të vazhdueshme, dhe lehtësisht të shpjegueshme, të kanë gërryer. Por deri në njëfarë pike, duhet t'i lësh që të ikin. Kjo gjë do të të çmendë. Në qoftë se do t'i lejosh që të të pushtojnë kështu, do të përfundosh në depresion dhe...

Fjalët e tij u shuan.

- Si gjyshi im?

- Nuk e thashë këtë.

- Nuk ke pse ta thuash.

Stageri ia nguli sytë dhe i mbajti për një sekondë, a më gjatë.

- Babai yt do të donte që ti të ecje përpara.
Ajo nuk tha asgjë.
- Ti e di që unë po them të vërtetën.
- E di, - tha ajo.
- Por?
- Por nuk mund ta bëj. Edhe babai im do ta dinte këtë gjithashtu.

KEJTI mbushi edhe një gotë tjetër të vogël me *Jack Daniel's* dhe filloi të printojë dosjen e vjetër të vrasjes së të atit.

Kjo nuk ishte dosja zyrtare e policisë. Sigurisht, ajo e kishte lexuar atë shumë herë më përpara. Kjo ishte sipas krijimit të saj, e mbushur me çdo gjë në dosjen zyrtare, detektivët që e kishin mbyllur çështjen e babait të saj kishin qenë që të dy miq të familjes, plus çdo gjë, edhe thashethemet, ajo kishte mundur t'i fiksonte sipas variantit të vet. Çështja kishte qenë mjaft e fortë dhe gjëja kryesore ishte se ata kishin një pohim nga vetë Leburni, plus armën e vrasjes, që u gjet e fshehur në shtëpinë e Leburnit. Shumica e detajeve ishin të lidhura bukur, me një përjashtim të rëndësishëm, që gjithmonë e kishte shqetësuar Kejtin: Në vendin e vrasjes kishte pasur gjurmë gishtash të paidentifikuara. Djemtë e laboratorit kishin gjetur një gjurmë të plotë, të qartë në rripin e babait të saj dhe e kishin ndjekur në sistem, por nuk kishin marrë asnjë të dhënë.

Kejti nuk kishte qenë asnjëherë plotësisht e kënaqur me versionin zyrtar, por të gjithë, përfshirë

edhe vetë Kejtin, e kishin lënë mënjanë për shkak të lidhjes personale. Akua kishte thënë gjënë më të bukur, një ditë kur ajo u takua me të në park, në një nga ditët e tij më të kthjellëta:

- Ti në këtë rast po kërkon diçka, të cilën nuk ke për ta gjetur kurrë.

Akua.

Këtu kishte diçka të çuditshme. Ajo mund të fliste me Stejsin për vrasjen e babait të saj, por Stejsi asnjëherë nuk e kishte takuar atë njeri. Stejsi nuk e njihte “Kejtin e vjetër”, Kejtin e mëparshme, atë që takohej me Xhefin dhe qeshte lirshëm, Kejtin që ekzistonte përpara vrasjes së Henri Donovanit. Por emri i parë që i erdhi në mendje, pra personi i vetëm që mund ta kuptonte më shumë se cilido tjetër se çfarë po ndodhte, ishte domosdo Xhefi.

Kjo nuk dukej ndonjë ide shumë e mirë, apo jo?

Jo. Të paktën, nuk ishte në orën gjashtë të mëngjesit apo në dhjetë të natës. Por tani, në orën tre të mëngjesit, me disa gota *Jack* që rridhnin nëpër damarët e Kejtit, kjo gjë dukej si ideja më brilante në historinë e botës. Ajo pa jashtë, nga dritarja e apartamentit. Thonë se Nju-Jorku është qyteti që nuk fle kurrë. Ky ishte budallallëk. Kur ajo kishte ndenjur në qytete të tjera, edhe më të vogla, si St. Louis ose Indianapolis, njerëzit dukej që rrinin vonë, megjithëse, kishte të ngjarë që kjo ndodhte më shumë nga dëshpërimi sesa nga çdo gjë tjetër. Ne nuk jemi qyteti i Nju-Jorkut, prandaj duhet të punojmë më shumë që të jetojmë mirë. Diçka e tillë.